

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6864
E shtunë, 1 prill 2023
çmimi 0.40 €

U vihet flaka edhe tri veturave me targa RKS në veri



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TË DIELËN NË PRISHTINË ORGANIZOHET MARSH QYTETAR DHE SOLIDARIZUES NË MBËSHTETJE TË LUFTËS SË DREJTË TË UÇK-SË DHE ISH-KRERËVE TË SAJ

MOBILIZIM I MADH PËR MARSHIN PËR DREJTËSI



Marshi qytetar dhe solidarizues në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj "Marshojmë për drejtësi" ka marrë mobilizim të madh në gjithë vendin.

Të dielën marshi do të nisët nga sheshi "Zahir Pajaziti" dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit "Skënderbeu". Deri të premtën ky marsh ka marrë mbështetje të

madhe nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, parti politike, deputetë, shoqëria civile, artistë, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe nga disa oda ekonomike

AKTUALE



SHËNOHET PËRVJETORI I PARË I MASAKRËS NË BUÇA, ZELENKY ZOTOHET PËR NDËSHKIM TË PËRGJEGJËSVE

KONJUFCA TAKON MËRGATËN SHQIPTARE NË UASHINGTON

KURTI ZBULOI PLLAKËN PËRKUJTIMORE TË MASAKRËS SË PASTASELIT

EKONOMI



KEDS-I NDËRTON LINJËN E RE MBI 60 KM NË GJAKOVË, PËRFITONJË RRETH 10 MIJË QYTETARË

BESIAN MUSTAFA: DY HERË RRRIT ÇMIMI I ENERGJISË PËR DY VJET QEVERISJE TË KURTIT

SPORT



KELMENDI: GRATË NË KOSOVË JANË MË PUNËTORE, KUR KANË NJË QËLLIM ASGJË NUK MUND T'I NDALOJË

RRYMA SHTRENJTOHET MBI 15 PËR QIND



NETOKRACIA

Shkruan:
Blerim REKA



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shënohet përvjetori i parë i masakrës në Buça, Zelensky zotohet për ndëshkim të përgjegjësve

KIEV, 31 MARS - Ukraina e ka shënuar më 31 mars njëvjetorin e tërheqjes së forcave ushtarake ruse nga qyteza Buça, duke lënë mbrapa qindra trupa të civilëve të vrarë nëpër rrugë. Kievi i ka konsideruar ngjarjet në Buça masakër dhe krime ruse.

Në një video të publikuar në rrjetet sociale, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e ka quajtur masakrën në Buça "simbol të mizorive" të kryera nga ushtria ruse. "Ne nuk do të harrojmë kurrë. Ne do t'i ndëshkojmë të gjithë fajtorët", ka thënë Zelensky përmes një deklarate.

Rusia e ka mohuar kryerjen e masakrës dhe ka pretenduar se vdekjet janë inskenuar nga Ukraina.

Zyrtarët ukrainas vlerësojnë se rreth 400 trupa të civilëve janë gjetur në Buça dhe një total prej më shumë se 1 000 trupave janë gjetur në rajonin rreth Kievit. Shumica e trupave janë varrosur në varreza masive.

Hetuesit ukrainas dhe ata ndërkombëtarë kanë nisur hetime për krime të luftës në Buça, Iripin dhe lokacione të tjera në Ukrainë ku kanë ndodhur masakrat. "Një vit më parë Ukraina e ka çliruar Buçën dhe bota është zgjuar me fytyrën e vërtetë të pushtuesit rus. Buça është skenë krimi dhe



simbol për të gjitha krimet ruse - vrasjet masive, dëbimet dhe shkatërrimin e të gjitha qyteteve", ka thënë kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas, përmes një postimi në

"Twitter". "Nuk ka kthim mbrapa - Rusia do të mbahet përgjegjëse". Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Presidenti rus, Putin, e quan

luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e

këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Turqia ratifikon aplikimin e Finlandës për anëtarësim në NATO

ANKARA, 31 MARS - Finlanda do të bëhet anëtarja më e re e NATO-s, pasi Parlamenti i Turqisë ka votuar për ta ratifikuar anëtarësimin e saj në aleancën veriatlantike.

Turqia e ka vonuar këtë ratifikim që disa muaj - duke u ankuar se ky shtet nordik është duke i mbështetur "terroristët".

Suedia, e cila ka aplikuar bashkë me Finlandën për anëtarësim në NATO, ende është duke u bllokuar nga Ankaraja për ankesa të njëjta. Secili zgjerim i NATO-s duhet të bëhet me miratimin e të gjitha vendeve anëtare.

Finlanda do të pranohet zyrtarisht në NATO në samitin e



radhës që mbahet në muajin korrik në Lituani.

Përmes një deklarate, pas votimit

në Parlamentin turk, Qeveria e Finlandës ka thënë se anëtarësimi në aleancë e forcon sigurinë e

shtetit dhe e përmirëson stabilitetin dhe sigurinë në rajonin e Baltikut. "Si aleatë ne do të japim dhe pranojmë siguri. Ne do ta mbrojmë njëri-tjetrin. Finlanda mbështet Suedinë tani dhe në të ardhmen në aplikimin e saj", ka thënë kryeministrja finlandeze Sanna Marin përmes një postimi në "Twitter".

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan e ka dhënë miratimin e tij për anëtarësimin e Finlandës në NATO, më herët gjatë muajit mars, duke thënë se ky shtet ka bërë "hapa konkretë" për sigurinë e Turqisë.

Mirëpo armiqësia e tij e vazhdueshme me Suedinë ka

qenë e qartë, pasi ai e akuzon këtë shtet për strehim të militantëve kurdë dhe që u jep mundësi atyre të protestojnë në rrugët e Stokholmit.

Vendimi i Ankarasë për ta ratifikuar anëtarësimin e Suedisë hap rrugën për një prej momenteve më të rëndësishme në historinë e NATO-s.

Finlanda, shtet me kufi prej 1 340 kilometrash me Rusinë, ka hequr dorë nga neutraliteti pas nisjes së luftës së Ruisë në Ukrainë në shkurt të vitit 2022.

Edhe Suedia ka hequr dorë nga neutraliteti mirëpo, për dallim nga Finlanda, ajo nuk ndan kufi me Rusinë.

Austri: Deputetët e së djathtës ekstreme lëshojnë sallën ku mbante fjalim Zelensky

VJEN, 31 MARS - Më shumë se 20 deputetë austriakë të ekstremit të djathtë e kanë lëshuar një seancë në të cilën ka mbajtur fjalim presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky. Politikanët e Partisë Liria (FPO) kanë thënë se fjalimi i Zelenskyt e ka shkelur

neutralitetin e Austrisë. Ata kanë paralajmëruar në nisje të fjalimit se do të bëjnë një lloj të protestës kundër adresimit të Zelenskyt.

Austria ka thënë më parë se nuk mund t'i ndihmojë ushtrisë ukrainase, mirëpo e mbështet Kievin në aspektin

politik.

Përmes një videoadresimi Zelensky e ka falënderuar Austrinë për ndihmën humanitare dhe ofrimin e ndihmës për pastrim të minave. Ai e ka mbajtur fjalimin në ditën e 400 të nisjes së luftës në Ukrainë.



U vihet flaka edhe tri veturave me targa RKS në veri

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 MARS - Policia e Kosovës ka bërë me dije se në orët e para të së premtes janë djegur tri vetura me targa RKS - Republika e Kosovës, të cilat u përkasin banorëve të nacionalitetit serb në veri. Sipas policisë, një veturë është djegur në Zvečan, dy të tjera në Mitrovicë të Veriut. Dy vetura të tjera me targa RKS, në pronësi të serbëve lokalë, janë djegur edhe më 30 mars. "Sikurse edhe në rastin e parë, edhe në rastin e dytë, pas pranimit të informacioneve, njësitet policore menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes, duke angazhuar njësitë kompetente policore, përfshirë forenzikën, të cilat kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore", është thënë në komunikatën e policisë.

Ish-kryeministri dhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se incidentet e 2-3 ditëve të fundit në veri janë tregues seriozë se mund të ketë një skenar të pengimit të zgjedhjeve në veri, me pasoja edhe për sigurinë në atë zonë. "Refuzimi i Listës Serbe për të marrë pjesë në zgjedhjet lokale atje shpërfaq mosgatishmërinë e palës serbe që ta zbatojë marrëveshjen e arritur në Bruksel. Serbia dhe Kosova



duhet urgjentisht të fillojnë përbushjen e obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Brukselit dhe Aneksi i Ohrit. Presidenti i Serbisë të heqë dorë nga destruktiviteti dhe t'i urdhërojë njerëzit e tij të heqin dorë nga sulmet e dhunshme", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka kërkuar nga BE-ja dhe ShBA-ja t'i shfrytëzojnë gjithë mekanizmat e tyre që ta mbrojnë suksesin e arritur me Marrëveshjen për Normalizimin e Marrëdhënieve Kosovë - Serbi, të

sponsorizuar prej tyre, si bazë e fortë e rivendosjes së rendit dhe ligjit në veri të Kosovës. "Në të kundërtën angazhimi i jashtëzakonshëm i të gjitha palëve për këtë marrëveshje do të mbetet përpjekje pa rezultat. Nëse marrëveshja nuk reflekton me një normalitet në terren, efektet e saj do të jenë të papërfillshme. Paqja në Kosovë është e paalternativë dhe i inkurajoj të gjitha palët të jenë të pakompromis në vendosmërinë e tyre për t'i mënjeluar të gjithë ata që e

rrezikojnë edhe marrëveshjen edhe sigurinë", ka thënë Haradinaj.

Edhe shefi i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka dënuar aktin e djegies së veturave të qytetarëve të nacionalitetit serb në veri të vendit. Szunyog përmes një postimi në "Twitter" ka shkruar se kjo vepër që ka ndodhur gjatë dy ditëve të fundit, me qëllim të frikësimit të popullatës lokale, është e mjerueshme, e papranueshme dhe duhet dënuar. "Dënojmë ashpër djegien e automjeteve të

reregjistruara së fundmi me targa të Kosovës në veri të Kosovës. Shkatërrimi i pronës private, që ka ndodhur gjatë dy ditëve të fundit, me qëllim të frikësimit të popullatës lokale, është i mjerueshëm, i papranueshëm dhe duhet dënuar nga të gjithë aktorët përkatës", ka shkruar ai. Ai u ka bërë thirrje organeve të zbatimit të ligjit që t'i identifikojnë dhe ndjekin përgjegjësit e këtyre veprave.

Raste të ngjashme në veri janë raportuar edhe në fund të vitit të kaluar, kur ka pasur tensione lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës që të gjitha makinat me targa ilegale serbe të reregistrohen në RKS. Në shenjë pakënaqësie me këtë vendim, por edhe për shkak të arrestimit të një ish-polici serb të Kosovës, serbët lokalë patën ngritur barrikada. Më pas, Kosova dhe Serbia, nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, kanë arritur marrëveshje për targa.

Kosova ka hequr dorë nga masat ndëshkuese nëse nuk bëhet reregjistrimi i makinave, derisa Serbia ka thënë se nuk do të lëshojë më targa të reja për makinat që qarkullojnë në Kosovë.

Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës nuk ka treguar se sa makina me targa të tilla janë reregjistruar në RKS. Vlerësohet se në veriun e Kosovës janë rreth 10 000 makina me targa të lëshuara nga Serbia.

Konjufca takon mërgatën shqiptare në Uashington



UASHINGTON, 31 MARS - Gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka zhvilluar një takim me mërgatën shqiptare në Uashington, afaristë, profesionistë dhe aktivistë të shoqërisë civile. Në takimin e realizuar në Ambasadën e Kosovës i pranishëm ishte edhe ish-

ambasadori William Walker, i cili e inkurajoi Kosovën ta vazhdojë rrugën e reformave dhe modernizimit të shoqërisë së saj. Në adresimin e tij para bashkatdhetarëve, kryetari Glauk Konjufca foli për situatën aktuale në Kosovë dhe për përparimin e arritur në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të

organizuar, duke u ndalur në rëndësinë e zhvillimit të ekonomisë dhe të investimeve, si dhe nevojën për të punuar për integrimin e Kosovës në familjen e BE-së.

Kryetari i Kuvendit vlerësoi lart përpjekjet dhe ndihmën e diasporës kosovare dhe ritheksoi se institucionet e Kosovës janë të

hapura për t'i dëgjuar mendimet dhe sugjerimet e tyre në çështjet që kanë të bëjnë me Kosovën.

Konjufca konfirmoi se dyert e investimeve në vendlindjen e tyre janë të hapura sot më shumë se kurdoherë më parë.

Gjatë bashkëbisedimit me bashkatdhetarë u diskutua edhe për proceset aktuale në Kosovë dhe

për sfidat e ardhshme, si dhe për forcimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe ShBA-së, duke përfshirë ekonominë, arsimin, kulturën dhe sigurinë.

Bashkatdhetarët u shprehën se kanë shumë interes dhe dëshirë për të ndihmuar në zhvillimin e Kosovës, veçanërisht në fushat e arsimit dhe zhvillimit ekonomik.



TË DIËLËN NË PRISHTINË ORGANIZOHET MARSH QYTETAR DHE SOLIDARIZUES
NË MBËSHTETJE TË LUFTËS SË DREJTË TË UÇK-SË DHE ISH-KRERËVE TË SAJ

Mobilizim i madh për marshin për drejtësi

Marshi qytetar dhe solidarizues në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj “Marshojmë për drejtësi” ka marrë mobilizim të madh në gjithë vendin. Të dielën marshi do të nisët nga sheshi “Zahir Pajaziti” dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit “Skënderbeu”. Deri të premten ky marsh ka marrë mbështetje të madhe nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, parti politike, deputetë, shoqëria civile, artistë, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe nga disa oda ekonomike

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 31 MARS - Këtë të diel platforma “Liria ka emër” organizon marsh qytetar dhe solidarizues në mbështetje të luftës së drejtë të UÇK-së dhe ish-krerëve të saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëlufetarëve të tyre.

Marshi do të nisët nga sheshi “Zahir Pajaziti” dhe do të vazhdojë në drejtim të sheshit “Skënderbeu”. Deri më tani ky marsh ka marrë mbështetje të madhe nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, disa parti politike, deputetë, shoqëria civile, artistë, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe nga disa oda ekonomike.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në të gjitha nivelet dhe me të gjitha kapacitetet e saj është duke u mobilizuar për pjesëmarrje masive në mbështetje të marshit për

drejtësi - në shenjë solidarizimi me ish-krerët e UÇK-së.

Kryetari Memli Krasniqi, anëtarët e kryesisë, deputetët e grupit parlamentar, kryetarët e komunave që udhëhiqen nga PDK-ja, drejtorët, asamblistët, degët, nëndegët dhe aktivistët PDK-së në të gjithë Kosovën, kanë dalë në mbështetje të këtij marshi fuqishëm dhe në të gjitha format për të dërguar një mesazh të qartë, të drejtë dhe të ndjerë tek ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Liria Ka Emër - UÇK! “Të dielën, më 2 prill, në ora 14:00 në sheshin ‘Zahir Pajaziti’ në Prishtinë, të gjithë bashkë do të marshojmë për drejtësi: Për drejtësinë e luftës sonë çlirimtare, për drejtësinë e historisë sonë më të lavdishme, për ata që na sollën lirinë. Ejani të gjithë të marshojmë për drejtësi!”, është theksuar në njoftimin e PDK-së. Bashkësia Islame e Kosovës përkrah dhe mbështet marshin për drejtësi të ftuar nga iniciativa

“Liria ka emër” në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. “Bashkësia Islame e Kosovës beson fuqishëm në pastërtinë e luftës së drejtë të UÇK-së dhe vlerëson lart sakrificën e UÇK-së për lirinë e vendit, si një nga vlerat më të larta e të shenjta të popullit tonë”, thuhet në njoftimin për medie.

Me këtë rast, Bashkësia Islame e Kosovës fton dhe bën apel te të gjithë besimtarët që në shenjë respekti e vlerësimi për sakrificën sublime të UÇK-së, dhe për hir të të gjithë atyre dëshmorëve që dhanë jetën për liri, të marshojmë të gjithë së bashku për drejtësi për ish-krerët e UÇK-së, në mënyrë që t’u dalin zot vlerave tona të shenjta.

Edhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe Kulturës do të jetë pjesë e marshit për drejtësi të paralajmëruar nga iniciativa “Liria ka emër”.

Në njoftimin e SBASHK-ut thuhet se anëtarësia e kësaj

sindikate do të marrë pjesë në këtë marsh. “SBASHK-u, në takimin me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve, përveç për temat aktuale në arsim dhe në aktivitetet sindikale, ka bashkëbiseduar edhe për kërkesën e shumë kolegeve e kolegëve tanë që nga çerdhet e deri në universitete për mbështetjen e aktivitetit ‘Marshojmë për drejtësi’ organizuar nga iniciativa ‘Liria ka emër’. Në këtë takim pjesëmarrësit njëzëri kanë vendosur që edhe SBASHK-u me një numër të konsiderueshëm të anëtarësisë të marrë pjesë në këtë aktivitet”, theksohet në njoftimin e SBASHK-ut.

Deri më tani ky marsh ka marrë mbështetje të madhe nga organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, disa parti politike, deputetë, shoqëria civile, artistë, shoqata dhe organizata të ndryshme dhe nga disa oda ekonomike.

Ideatori i platformës “Liria ka emër”, Ismail Tasholli, në një intervistë për gazetën “Epoka e re”, ka theksuar se ky marsh do të përçojë dy mesazhe: njëri mesazh do të jetë thirrje për drejtësi, tjetri për shprehje të mirënjohjes. Ai ka thënë se është i nevojshëm përbashkimi i

shoqërisë sonë rreth disa temave që janë premisa mbi të cilat janë ndërtuar dinjiteti dhe krenaria jonë kombëtare.

Tasholli ka theksuar se deri më tani në çdo takim që kanë pasur, “Marshi për drejtësi” ka marrë mbështetje maksimale. “Të gjithë janë të vetëdijshëm për peshën e situatës ku ndodhemi sot dhe e konsiderojnë përkrahjen të nevojshme. Tekfundit, secili e respekton veten kur respekton periudhën më të ndritur të historisë së re të vendit tonë qoftë edhe nëpërmjet simbolikës së marshit”, ka thënë ai.

Tasholli në këtë intervistë ka thënë se UÇK-ja i përket secilit qytetar të këtij vendi, duke theksuar se ish-krerët e saj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëlufetarët e tyre, nuk janë emra të përveçëm, por janë disa nga emrat e lirisë. “Duhet të jemi shumë të vëmendshëm në kompleksitetin e ngjarjeve që po rrjedhin atje, duke lënë anash hidhërimet politike tipike ballkanike dhe ta dëshmojmë maturinë si veprim të përbashkuar. Mos ta harrojmë, duke mbrojtur ata atje e mbrojmë vetveten, mbrojmë të ardhmen tonë”, ka deklaruar Tasholli.

Kurti zbuloi pllakën përkujtimore të masakrës së Pastaselit

RAHOVEC, 31 MARS - Në 24-vjetorin e masakrës së Pastaselit, kryeministri Albin Kurti bëri homazhe të lapidari dhe varrezat e dëshmorëve. Së bashku me tre të mbijetuarit e kësaj masakre dhe kryetarin e komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, zbuloi pllakën përkujtimore të të rënëve në fshatin Pastasel të komunës së Rahovecit. Duke kujtuar viktimat e gjenocidit

të Serbisë, kryeministri Kurti tha se të përbashkuar në këtë vend, ku forcat serbe e kryen masakrën e Pastaselit plot 24 vjet më parë, shënojmë historinë e këtyre viktimave dhe denoncojmë kryerësit e këtij krimi. "Kjo masakër, nga e cila ende ka persona të zhdukur, u krye vetëm një javë pas fillimit të fushatës ajrore të bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavi, duke vrarë e

masakruar 106 shqiptarë. Pushkatimet këtu kanë ndodhur në disa grupe dhe grupi i parë i të pushkatuarve është përbërë nga fëmijët prej moshës 13 deri në moshën 17-vjeçare. Kjo tregon se çfarë mizorie e barbarie përbën krimi i pashembullt i Serbisë gjenocidale këtu në Pastasel më 31 mars të vitit 1999", ka thënë Kurti. Ai tha se si përfaqësues e

udhëheqës të institucioneve të Republikës së Kosovës bashkërisht e kemi për obligim t'i nderojmë dhe t'i kujtojmë të gjitha jetët njerëzore që u shuan nga vrasjet e kryera nga regjimi fashist i Sllobodan Millosheviqit dhe i autoriteteve të tjera të Serbisë urdhërdhënëse e ekzekutore. "Ngritja e kësaj pllake përkujtimore është jo vetëm një shenjë, por edhe një zotim i yni

ndaj kujtesës sonë si popull dhe ndaj kërkesës sonë për drejtësi", ka deklaruar kryeministri Kurti. Në këtë tubim përkujtimor të pranishëm ishin edhe ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, deputetë të Kuvendit të Kosovës, kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Andin Hoti, si dhe përfaqësues institucionale e qytetarë të shumtë.



BE-ja: Marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë për targa nuk ka afate kohore

PRISHTINË, 31 MARS - Marrëveshja e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë për targa e makinave në nëntor të vitit të kaluar nuk ka afate kohore apo afat skadimi, ka konfirmuar zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano. Në një përgjigje me shkrim për medie, Stano ka përsëritur se i dërguari i BE-së për dialogun mes dy vendeve, Miroslav Lajçak, i ka ftuar kryenegociatorët për një takim në Bruksel më 4 prill. Sipas burimeve të "Radios Evropa e Lirë" në Bruksel, në takimin e 4 prillit do të diskutohet edhe për çështjen e targave.

Ai ka thënë se në takim do të diskutohen të gjitha hollësitë e lidhura me zbatimin e marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve, për të cilën palët kanë arritur pajtueshmëri më 27 shkurt në

Bruksel. "Ndërkohë, BE-ja pret që të dyja palët të vazhdojnë të kontribuojnë në atmosferën për normalizim, pajtim dhe zbatim të shpejtë të obligimeve. Po ashtu, palët janë zotuar të përmbahen nga veprimet që do të shkonin në drejtim të kundërt", ka thënë zëdhënësi i BE-së më 31 mars.

Më 23 nëntor të vitit të kaluar Kosova dhe Serbia kanë arritur një marrëveshje për ta tejkaluar krizën rreth targave të makinave. Deri atëherë Kosova pati insistuar në reregjistrimin e të gjitha makinave me targave serbe në RKS - Republika e Kosovës. Mirëpo me marrëveshjen e nëntorit, Kosova është zotuar për heqje dorë nga masat ndëshkuese lidhur me targat, derisa Serbia është zotuar se nuk do të lëshojë më targa ilegale. Ministria e Punëve të Brendshme



e Kosovës nuk ka treguar se sa makina me targa të tilla janë

reregjistruar në RKS. Vlerësohet se në veriu të Kosovës janë rreth 10

000 makina me targa të lëshuara nga Serbia.

Në spitalin e Gjilanit për dy muaj morën trajtim 104 pacientë me probleme pulmonare

GJILAN, 31 MARS - Reparti i Pulmologjisë, në kuadër të Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit, ofron shërbime në kushte moderne, pas rinovimit të bërë muaj më parë. Në këtë repart në dy

muajt e parë të këtij viti janë trajtuar 104 pacientë me probleme pulmonare. Trajtimin e këtyre pacientëve e kanë bërë katër mjekë specialistë së bashku me tetë infermiere të këtij

reparti. Sipas raportit të punës gjatë vitit 2022, gjithsej janë trajtuar 380 pacientë. Brenda javës në këtë repart trajtohen 14 pacientë, kurse brenda muajit deri në 55 pacientë.



KEDS-i ndërton linjën e re mbi 60 km në Gjakovë, përfitojnë rreth 10 mijë qytetarë

GJAKOVË, 31 MARS - Dalja e Cermjanit që derivon nga qendra e qytetit të Gjakovës e shkon në drejtim të fshatrave malore që degëzohen në njërin anë në drejtim të Deçanit e në anën tjetër në drejtim të Klinës, tashmë është ndërtuar thuajse komplet e re.

Ky projekt përbëhet prej tre largpërçuesve, atij të Cermjanit, Becit dhe Erenikut.

Të tri këto dalje janë shkrirë në një dalje të vetme dhe mbarojnë në fshatin Kralan të Gjakovës.

Kjo linjë është mbi 60 km e gjatë,

përderisa 24 kilometra do të jetë nëntokësore.

Në linjën nëntokësore, përskaaj magjistrale Gjakovë - Prishtinë, tashmë pusetat dhe elementet e tjera janë vendosur.

Nga aty ndahet degëzimi në Lugbunar që është rrjet ajror, në anën e kundërt të Aeroportit të Gjakovës, që zë shtat po në këtë fshat. Përgjatë këtij segmenti tashmë gjarpërojnë në një reliev kodrinoro-malor 817 shtylla të reja betoni dhe përçues të rinj elektrikë. Janë në ndërrim e sipër

gjithashtu plot 36 trafostacione.

Ky projekt madhor, i cili kap vlerën prej afër dy milionë eurosh, ka filluar në vitin 2021 dhe do të mbarojë së shpejti. Prej tij përfitojnë më shumë se 2 400 konsumatorë ose rreth 10 mijë qytetarë të asaj ane, duke pasur një rrjet të qëndrueshëm dhe furnizim stabil me energji elektrike.

Krahas këtij projekti, KEDS-i po kryen në të njëjtën kohë edhe projekte e investime të tjera në tërë territorin e Kosovës.



Shpërndahen motokultivatorë për fermerët në Podujevë



PODUJEVË, 31 MARS - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me drejtorin e organizatës së "Qatar Charity" në Kosovë, Esam Dabab, dhe drejtorin e Bujqësisë, Fatmir Rudari, morën pjesë në procesin e shpërndarjes së motokultivatorëve për 53 fermerët përfitues nga projekti i marrëveshjes në mes të komunës së Podujevës me

organizatën "Qatar Charity".

Fermerëve ua shpërndanë 39 motokultivatorë që janë me kosë dhe frezë, ndërsa 14 motokultivatorë me kosë, frezë dhe rimorkio do të shpërndahen në ditët në vijim. Për realizimin e këtij projekti komuna ka ndihmuar me 10 për qind të vlerës së projektit, kurse organizata nga Katari me 90 për qind.

Bulliqi i ka uruar fermerët përfitues nga ky projekt, ndërsa ka falënderuar drejtorin e "Qatar Charity" për ndihmën dhe bashkëpunimin në sfera të ndryshme që kanë me komunën, si dhe shprehur zotimin që ky bashkëpunim të thellohet edhe më tej, me qëllim të realizimit të sa më shumë projekteve në dobi të qytetarëve.

Stacioni i Autobusëve në Prizren tashmë menaxhohet nga komuna

PRIZREN, 31 MARS - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për transferimin e NSH "Kosovatrans" - Stacioni i Autobusëve në Prizren nga AKP-ja në administrimin dhe autorizimin e komunës së

Prizrenit.

Komuna e Prizrenit tashmë ka nën menaxhim N. Sh. "Kosovatrans" me të gjitha asetet dhe detyrimet që përcaktohen me ligjet në fuqi. "Ky akt është me rëndësi të veçantë për qytetarët e Prizrenit dhe për kompanitë e transportit të udhëtarëve si dhe do të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e tyre", u shpreh Totaj.



Osmani përkujton masakrën e Pastaselës të Rahovecit dhe atë të Burimit të Malishevës

PRISHTINË, 31 MARS - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka përkujtuar 24-vjetorin e masakrave në Pastaselë të Rahovecit dhe atë në Burim të Malishevës. "Sot kujtojmë masakrën e kryer nga forcat e regjimit gjenocidal të Serbisë

në Pastaselë të Rahovecit, me ç'rast u vranë dhe u masakruan 106 banorë të këtij fshati dhe fshatrave përreth. Në të njëjtën ditë në Burim të Malishevës u vranë dhe u masakruan 42 civilë. Dhembja vazhdon të jetë po kaq e madhe sikur në ditën e

vrastjes së tyre, ndërsa kujtimi për ta i përhershëm. Drejtësia për viktimat e regjimit serb dhe zbardhja e fatit të zhdukurve me dhunë janë kërkesa të përhershme tonat nga të cilat ne nuk heqim dorë", është thënë në deklaratën e saj.



Netokracia



Shkruan: Blerim REKA

1. Pas agrarit dhe industrialit, bota po e jeton transformimin teknologjik, ku jo toka, as fabrika - por informatika, do të jenë lëvizës i progresit; e dija - fuqi. Bujqit, ishin zëvendësuar nga punëtorët (fenomeni "Ford" në SHBA, midis dy luftërave botërore); e këta të fundit nga robotet (modeli japonez i bazuar në dije, sipas Nonaka dhe Takeuchi). Post-industrializimi, post-moderna dhe post-historikja, ndërkaq dominuan diskursin e mendimit global. Pas autokracisë dhe demokracisë, në shekullin tonë po imponohet gjithnjë e më tepër një "sundim" i ri: netokracia. Nga sundimi i individit e sundimi i shumicës, po kalohet tek "sundimi" i të gjithëve, apo i

rrjeteve sociale. Nga: "shteti jam unë", në "shteti jemi ne" dhe tash, "shteti jemi të gjithë". Së paku virtualisht. Sundimi i parë ishte i pakontrolluar, i dyti i kontrolluar nga shumica, kurse ky i fundit, është jashtë kontrollit.

2. Rrjetet sociale krijuan një "sundim" të ri, ku secili nga gjashtë miliardë tokësorët e shprehin lirisht mendimin. Por, për sundimin e parë-atë autoritar (në Korenë e Veriut, Rusi e Kinë) netokracia po përjetohet si "kërcënim i sigurisë kombëtare", për çka vendosën ndalesa kundër rrjeteve perëndimore "armiqësore"! Por edhe rrjetet perëndimore janë "në luftë" satelitore si rasti i fundit: Starlink vs. Oneweb. Luftërat e ardhshme, nuk do të bëhen më vetëm për territore reale tokësore, por edhe për hapësira virtuale.

3. Cyberwar (midis shteteve) dhe Netwar (midis akterëve jo-shtetëror) ndryshuan edhe konceptin e Klauzevicit mbi luftën. Avionët pa pilotë dhe dronët e bënë reale, atë që para më shumë

dekadash mendonim se është vetëm trillim filmor i "Star Wars". Inteligjenca artificiale dhe Chat gpt po e ndryshojnë jo vetëm mendimin por edhe veprimin. Ne luftë, e në paqe. Diplomacia klasike po zëvendësohet nga ajo digjitale, depeshet e mbyllura me Tweet Diplomacy të hapur. Netokracia krijoi gjuhë universale dhe ndikim e fuqi globale.

4. Por revolucioni informativ nuk është fenomen i ri. Para 83 vitesh, Lasswell (1940), e kishte dhënë bazën e strategjive informative, me frazën e tij - tash më epike: "Kush - kujt, çka dhe si i tha, e me çfarë efekti"? ("Who says what, to whom via what channels, with what effects"). Pas tij, në vitin 1970, dy hulumtues të tjerë, Gierlach dhe Hine, dolën me konceptin: SPIN ("segmented, polycentric, ideologically interacted network"), i cili sot është bërë mjet manipulues i rrjeteve sociale dhe instrument i Hybrid War. Fake News u bënë manipulatore globale, duke zëvendësuar, në mënyrë të sofistikuar atë që quhej propagandë shtetërore. Hakerët u

imponuan si luftëtarë virtual që dekonspirojnë deri edhe sistemet më të klasifikuara shtetërore. Lufta kundër ushtarëve virtual është paraprakisht e humbur.

5. Cyber bota apo net bota e rrjeteve sociale sot, është ajo që në vitin 1992, largpamësi vizionar Ronfeldt e kishte quajtur: "Cyberocracy", apo sundimi kibernetik. Kuptohet edhe këtu u gjetën format

inkriminuese, që keqpërdorën vakuumin ndëshkues ligjor. Deri vonë, legjislacioni penal nuk sanksioninte Cybercrime, apo veprat penale kibernetike.

Po jetojmë, pra në netokraci, apo në kohën e sundimit të rrjeteve sociale. Deri në revolucionin e radhës.

(Autori është Shefi Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në New York)



Mesazh për bashkatdhetarët në Gjenevë: Të dielën votoni për Pierre Maudet



PRISHTINË, 31 MARS - Këtë të diel mbahen zgjedhjet në kantonin e Gjenevës për qeveri dhe parlament. Sali Bislimi, veprimtar dhe drejtor i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës", u ka bërë thirrje bashkatdhetarëve në Gjenevë që të votojnë për politikanin dhe mikun e shqiptarëve, Pierre Maudet. "Bashkatdhetarë të dashur, miq të mi në kantonin e Gjenevës. Pierre Maudet, mik imi dhe i kombit, të gjithë së bashku duhet ta nxjerrim fitimtar në zgjedhjet e së dielës, ku garon për këshilltar shteti dhe me listën nr. 4. Liberté et Justice Sociale për këshillin e lartë të kantonit të Gjenevës. Do

të kemi një rast unik si komunitet shqiptar ta kemi afër për të ardhmen dhe integrimin e komunitetit tonë këtu dhe një ndihmës i madh edhe për Kosovën tonë në integritet evropiane. Miku im i madh i duhet Gjenevës, Zvicrës dhe Kosovës. Ata që mbajnë në duar plisin mbajnë historinë tonë, vuajtjet tona, krenarinë tonë, e cila meriton ta gjejë vendin dhe vlerat perëndimore. Në mision për miqtë dhe atdheun me ngjyrat kuq e zi. Të dielën bëjeni një hap për mikun dhe Kosovën. Mos harroni, me shumë respekt për të gjithë ju!!!", ka shkruar Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër.

Një vit e gjashtë muaj burg ndaj një personi për ngacmim seksual në Gjakovë

GJAKOVË, 31 MARS - Gjykata Themelore në Gjakovë ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të pandehurit H. H., i cili akuzohet për veprën penale "Ngacmim seksual". Sipas një njoftimi, bëhet me dije pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, i pandehuri kishte pranuar fajësinë, gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej një viti e gjashtë muaj. "I pandehuri H. H. akuzohet se me datë 8 mars 2023 rreth orës 15:00 minuta, në rr. 'Fan S.

Noli' në Gjakovë, me dashje ngacmon seksualisht personat të cilat janë të ndjeshme për shkak të moshës së tyre, me qëllim të cenimit të dinjitetit të të dëmtuarave fëmijëve... në atë mënyrë që derisa të dëmtuarat ishin duke ecur në këmbë, në një moment e shohin të pandehurin, i cili ishte i zhveshur dhe bën me gjeiste duke ekspozuar organin gjenital në drejtim të dëmtuarave, të gjendur në këtë situatë të dëmtuarat ndërrojnë rrugën, por i pandehuri vishet

dhe niset në drejtim të tyre dhe u drejtohet me fjalën 'përsëndetje', më pas të dëmtuarat të frikësuara kërkojnë ndihmën e një kalimtarit të rastit, ku me të parë kalimtarin e rastit i pandehuri largohet me vrap nga aty, ashtu që me këto veprime i pandehuri të dëmtuarat ka shkaktuar cenimin e dinjitetit dhe ka krijuar një mjedis frikësues", thuhet në njoftim.

Po ashtu, në njoftim bëhet me dije se kundër këtij aktgjykimi,



palët kanë të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve nga dita e

pranimit të aktgjykimit në formë të shkruar.

Rryma shtrenjtohet mbi 15 për qind

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 31 mars - Energjia elektrike në Kosovë është shtrenjtuar për 15.4 për qind. Kështu vendosi më 30 mars Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Kryesuesi i këtij bordi, Ymer Fejzullahu, ka thënë se rritja ka ndodhur për shkak se mundëson furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike. “Ne konsiderojmë se nëse nuk kemi furnizim të qëndrueshëm me energji, kostoja do të jetë shumëfish më e madhe sesa përqindja e propozuar. Ky është minimumi për të pasur 24 orë energji elektrike”, ka thënë ai.

Tarifat e reja të rrymës do të hyjnë në fuqi nga 1 prilli.

Sipas tarifave të reja, zyrtarët e ZRRE-së thanë se për konsumatorët që kanë konsum shtëpiak deri në 300 kilovat në orë, nëse proporcioni i konsumit është 60 [tarifa e lartë] me 40 [tarifa e ulët], fatura mujore do të ketë rritje prej 2 euro e 88 centë.

Për ata që kanë konsum deri në 450 kilovat në orë, fatura mujore do të ketë rritje prej 4 euro e 18 centë.

Për konsumatorët që kanë



konsum deri në 600 kilovat në orë, rritja e faturës mujore do të jetë 5 euro e 49 centë. Dhe për konsumatorët deri në 800 kilovat, ku 80 për qind e konsumatorëve janë pjesë e kësaj kategorie, rritja mujore do të jetë rreth 7 euro e 23 centë.

Ndërkaq, për ata që konsumojnë 1.000 kilovat në orë, rritja mujore pritet të jetë 10 euro e 51 centë.

Kryesuesi i bordit të ZRRE-së, Ymer Fejzullahu, pas mbledhjes foli për gazetarët, duke treguar se kanë vendosur që rritja e energjisë të jetë për të gjitha kategoritë, dhe jo vetëm për një, sikurse ishte kërkuar që rryma të shtrenjtohej vetëm për

konsumatorët komercialë. “Ky vendim i prek të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Ata tashmë e kanë një mundësi dhe i lusim konsumatorët që të konsumojnë sa më shumë energji gjatë orëve jashtë pikut, kur çmimet e energjisë janë shumë më të favorshme”, ka thënë ai.

Më herët, Qeveria e Kosovës ka premtuar se do të vazhdojë subvencionimin e faturave për konsumatorët që kursejnë energjinë, edhe pas rritjes së tarifave nga ZRRE-ja.

Fejzullahu tha se do të diskutohet me Qeverinë “se si do të zbatohet ky subvencion, të cilin ata e kanë premtuar”.

Nga muaji shtator i vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës ka subvencionuar faturat e konsumatorëve, të cilët kanë kursyer së paku 5 për qind të energjisë së konsumuar në muaj, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Këta konsumatorë kanë përfituar dyfishin e përqindjes së kursyer.

Herën e fundit që ZRRE-ja kishte miratuar rritjen e tarifave ishte në shkurt të vitit të kaluar. Nga ai vendim u prekën konsumatorët shtëpiakë dhe komercialë që shpenzonin mbi 800 kilovat në orë. Kjo kategori e konsumatorëve u faturua me 12.5 cent për kilovat në tarifën e

lartë dhe 5.9 cent për tarifën e ulët.

Kosova ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavat rrymë në orë, ndërsa nevojat e saj, në ditë dimri, arrijnë deri në 1.300 megavat në orë. Këtë diferencë, ajo e importon nga jashtë.

Kosova importon rrymë sipas çmimit të energjisë elektrike në bursën hungareze HUPX.

Në gushtin e vitit 2021, çmimi ishte 150 euro për megavat.

Në muajin gusht të vitit 2022, çmimi arriti në rreth 430 euro për megavat, por më vonë u stabilizua në rreth 260 euro. Më 30 mars të vitit 2023, çmimi për megavat në bursën HUPX ishte 113 euro.

Ndryshe, veriu i Kosovës, i banuar me shumicë serbe, që nga përfundimi i luftës nuk paguan për rrymën e konsumuar. Nga viti 1999 deri më 2017, borxhi për veriu është paguar nga qytetarët e komunave të tjera të Kosovës. Faturat e tyre kanë qenë më të larta për 3.5 për qind.

Por, Gjykata e Apelit vendosi më 2017 që ta pezullojë këtë praktikë, që e konsideroi të paligjshme. Prej atij viti, pagesën e borxhit e bën Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (KOSTT).

Besian Mustafa: Dy herë rritet çmimi i energjisë për dy vjet qeverisje të Kurtit

EPOKA E RE **F. DËRMAKU**

Prishtinë, 31 mars - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur konferencë për medie, me ç’rast deputeti Besian Mustafa ka folur për rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Ai ka thënë se për herë të dytë në këto dy vite të kësaj qeverie qytetarëve po u rritet çmimi i energjisë elektrike, kësaj radhe edhe për 15,4 për qind. “E tëra kjo në këtë kohë krize kur çmimet e produkteve esenciale janë rritur deri në 50 për qind, kur tatimi në pronë është rritur për 100 për qind, kur pagat nuk janë rritur as në sektorin publik as në sektorin privat dhe kur kursimet pensionale në Trust janë zvogëluar për 156 milionë euro. Shtoj kësaj dhe faktin që vitin e kaluar investimet kapitale ishin realizuar për vetëm rreth 60 për qind, ndërsa qeveria mburret që i kanë tepruar qindra miliona euro dhe krijohet një pamje e qartë e dështimeve ekonomike të kësaj qeverie dhe të shtrydhjes financiare të familjeve kosovare”, ka theksuar ai.

Mustafa ka thënë se për të

përkeqësuar edhe më tej gjendjen në sektorin e energjisë, kjo qeveri për dy vite nuk ka investuar asnjë cent të vetëm në krijimin e kapaciteteve të reja vendore të gjenerimit të energjisë elektrike. “Qindra miliona euro të shpenzuara në subvencionim të çmimit të rritur të energjisë nuk e zgjidhin problemin afatgjatë të energjisë. Investimi i këtyre milionave në krijimin e kapaciteteve të reja gjeneruese është e vetmja zgjidhje afatgjatë e qëndrueshme. Për më keq, procesi i remontit të blloqeve të KEK-ut ishte vonuar shumë gjatë këtyre dy viteve duke ulur ndjeshëm prodhimin vendor dhe duke rritur nevojën për import të energjisë, me çmime tejet të larta”, është shprehur Mustafa. Ai ka theksuar se qeveria nuk mori parasysh as kërkesën e LDK-së për uljen e TVSh-së në faturat e energjisë në zero për qind deri në tejkalimin e kësaj krize së cilës nuk po i shihet fundi, si rezultat i mospunës së tyre. “Qeveria duhet urgjentisht të investojë në krijimin e kapaciteteve vendore të gjenerimit të energjisë elektrike në partneritet të plotë me



sektorin vendor dhe ndërkombëtar. Këto investime duhen përqendruar tek burimet e ripërtërishme të energjisë si dhe tek termocentrali me gaz si opsioni më i mirë që garanton tranzicion të qëndrueshëm. Në mungesë të investimeve në

kapacitete vendore të energjisë elektrike, kjo Qeveri po dëmton rëndë ekonominë familjare si dhe prodhuesit vendor duke i bërë konkurrent të dobët me prodhuesit e rajonit dhe më gjerë”, ka thënë ai.

Deputeti i LDK-së i ka bërë

thirrje qeverisë që sa më parë të fillojë investimet në gjenerimin vendor të energjisë elektrike, veçanërisht nga burimet e ripërtërishme dhe gazit natyror si dhe uljen TVSh-së në faturat e energjisë elektrike në zero për qind deri në tejkalimin e kësaj krize.

AJAZ EMINI - Ditar (VI)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Nga kjo telefonatë siç po dukej edhe Gjenerali ishte shumë entuziast për takimin sa më të shpejtë në mes nesh, dhe ishte i gatshëm për të na ofru çfarëdo ndihme qoftë edhe atë në çdo moment, dhe na tha se mundë që të nisemi dhe që të shkojmë te ai tani për menjëherë. Ne veçse ishim në pritje dhe të gatshëm, menjëherë pas fjalëve të tijë u nisëm drejt zyrës së tij. Por kësaj herë për të shkuar atje ia dhamë edhe vrapit që nga dera e zyrës tonë, kështu që atë distancë disa kilometërshë për deri te zyra e Gjeneralit e kaluam vetëmse mbrenda disa minutash. Sa për rojen në hyrje të kazermës të Ushtrisë së Shqipërisë nuk i dhamë kohë as që të na pyeste se për ku ishim nisë, pasi se neve tani që të gjithë personeli ushtarak i kazermës së Kukësit na njifnin shumë mirë sepse ishim të përditshëm. Unë vetëmse në shpejtësi i thashë se Gjenerali Lama na ka thirrë urgjentisht që të shkojmë te ai, dhe pa kurrëfarë ndalësie ia dhamë shkallëve përpjetë për në zyrën e tij e cila ndodhej në katin e dytë të ndërtesës. Kësaj here nuk e pamë rojen e Gjeneralit para dera, trokitëm në derë dhe na hymë mbrenda duke përfunduar edhe listën me objektivat më të reja, të posa marrura prej zyrës së Gjeneral Çekut të UÇK-së. Shpejtë e shpejtë i verifikuam dhe i konfirmuam në hartë, i kopjuam dhe përsëri pa kurrëfarë vonese ia dhamë me vrap rrugicës së shpatit përpjetë për në zyrën tonë të punës. Gjatë rrugës, nga vrapit edhe lodhja që të dy u zumë në frymë. Unë u ndala te dera që të freskojë fytyrën në çeshmen që kishim aty afër dhe kurë sapo u ktheva në zyrë, e pashë se Kapiteni Wiggis veçse kishte fillu me ia transmetu me radio-lidhje objektivat më të reja Shtabit në Rinas. Gjatë pushimit më vonë, Gjenerali Lama na dërgoi edhe disa objektiva më të reja nëpërmjet kuririt të tij personal, i cili ishte një djalë i ri, ndoshta ushtarak i tij! U gëzuam edhe më tepër, sepse tani kishim filluar që të bëjmë mjaftë materiale me furnizim të mirë të objektiveve serbe me qëllim që ta shkatërrojmë sa më shpejtë agresionin që po zhvillohej në Kosovë nga forcat paramilitare ushtarake serbe. Për derisa ishim duke i dhënë informacionet e reja Shtabit në Rinas, mbi kokat tona veçse filloi të ndëgjohet zhurma e motorëve të bombarduesve të aviacionit të NATO-së, që po kalonin mbi qiellin e hapur të qytetit të Kukësit për të hyrë mbrenda Kosovës, dhe për të qëlluar caqet e paramilitareve dhe ushtarisë serbe. Menjëherë pas disa minutash filluan të ndëgjohen krismat dhe dridhjet e tokës nga bombarduesit e NATO-së që po qëllonin mbi kokat e forcave serbe jo aq shume largë prej nesh. Ne pamë se në bombardime po merrnin pjesë bombarduesit Amerikan F-14, A-10 si dhe bombarduesit e mëdhenjë B-1 dhe B-52, të cilët



20 Qershor 2000, Sojevë /Kosovë, Ajaz Emini me Gjeneralin e UÇK's Agim Cekun

për të shkuar përsëri te zyra e Gjeneralit Lama për ta takuar pa lajmëruar askend, as edhe vetë Gjeneralin! Trokitëm në derë dhe hymë mbrenda aty ku gjetëm Gjeneralin duke përfunduar edhe listën me objektivat më të reja, të posa marrura prej zyrës së Gjeneral Çekut të UÇK-së. Shpejtë e shpejtë i verifikuam dhe i konfirmuam në hartë, i kopjuam dhe përsëri pa kurrëfarë vonese ia dhamë me vrap rrugicës së shpatit përpjetë për në zyrën tonë të punës. Gjatë rrugës, nga vrapit edhe lodhja që të dy u zumë në frymë. Unë u ndala te dera që të freskojë fytyrën në çeshmen që kishim aty afër dhe kurë sapo u ktheva në zyrë, e pashë se Kapiteni Wiggis veçse kishte fillu me ia transmetu me radio-lidhje objektivat më të reja Shtabit në Rinas. Gjatë pushimit më vonë, Gjenerali Lama na dërgoi edhe disa objektiva më të reja nëpërmjet kuririt të tij personal, i cili ishte një djalë i ri, ndoshta ushtarak i tij! U gëzuam edhe më tepër, sepse tani kishim filluar që të bëjmë mjaftë materiale me furnizim të mirë të objektiveve serbe me qëllim që ta shkatërrojmë sa më shpejtë agresionin që po zhvillohej në Kosovë nga forcat paramilitare ushtarake serbe. Për derisa ishim duke i dhënë informacionet e reja Shtabit në Rinas, mbi kokat tona veçse filloi të ndëgjohet zhurma e motorëve të bombarduesve të aviacionit të NATO-së, që po kalonin mbi qiellin e hapur të qytetit të Kukësit për të hyrë mbrenda Kosovës, dhe për të qëlluar caqet e paramilitareve dhe ushtarisë serbe. Menjëherë pas disa minutash filluan të ndëgjohen krismat dhe dridhjet e tokës nga bombarduesit e NATO-së që po qëllonin mbi kokat e forcave serbe jo aq shume largë prej nesh. Ne pamë se në bombardime po merrnin pjesë bombarduesit Amerikan F-14, A-10 si dhe bombarduesit e mëdhenjë B-1 dhe B-52, të cilët

tani do të rrafshonin çdo gjë mbi tokë! Tani pamë edhe raste kur mbi ne silleshin aeroplanë luftarak të NATO-së dhe që po pritnin radhën e tyre për të hyrë në arenën e bombardimeve në Kosovë, për shkak se tani ndoshta kishin aktivizuar të tërë flotën e aviacionit bombardues. Bombardimet zgjatën gjatë tërë ditës, por u intensifikuan sidomos në orët e pasditës dhe mbrëmjes, dhe të cilat vazhduan deri në orët e herëshme pas mesnate. Edhe sot caqet kryesore ishin ne Verbnicë, Planej edhe rreth Zhurit, aty ku ishte përqëndrimi më i madh i forcave të armikut serb. Porosia që morëm nga Gjenerali Hendrix ishte, që nga bombardimet gjithëçka të rrafshohet me tokë, që mos të shifet me ndonjë pjesëtarë i gjallë i forcave serbe, pasi tani dihej se në këtë pjesë të Kosovës nuk kishte mbetë më popullatë civile, e gjithë popullata ishte zbrazë nga këto troje pasi se kishte shumë të vrarë e të tjerët kishin ikë, dhe kështu armiku serb bënte pastrimin etnik të të gjitha tokave shqiptare atje. Për këtë pjesë të Kosovës u dha leja që të përdoren gati se të gjitha llojet e armatimit që po dispononte Aleanca e NATO-së, tani po përdorëshin edhe bombat më të mëdha që kishin si ato më të rëndat Mavrick, bombat 200-300 kg., po edhe më të mëdha. Gjatë mbrëmjes, në orën 20:00 shkua përsëri që të takohemi me Gjeneralin Lama, prej të cilit morëm edhe një listë me objektivat e reja. Tani gjithëçka po lëvizte me tempo shumë më të shpejtë se më parë, diçka që ne po e pëlqenim shumë. Nga gëzimi për punën e suksesëshme që po bënim, Gjenerali Lama përsëri na faleminderoi dhe na përqafoi që të dyve, mua dhe kapitenin dhe na tha që t'i përsëndesim edhe t'i faleminderohemi edhe pjesëtarëve tjerë të grupit tonë, dhe na tha se kjo neve na jep

kurajo që të punojmë edhe më shumë, sepse kjo po na kënaqë të gjithëve edhe mua po edhe juve! Përsëri u ndëgjuan krismat e artilerisë serbe, e që tani po gjuanin edhe për mbrenda territorit të Shqipërisë, me çka po donim me siguri që të na bënin me dije se forcat serbe ende na qenkan të gjallë! Pas takimit që patëm përsëri u kthyem në zyrën tonë për të përfunduar detyrat tona, pra, edhe këtë listë objektivash që posa e morrëm. Kur ndëgjua kësaj here ndoshta edhe ofenzivën më të madhe se ndonjëherë të aviacionit bombardues të NATO-së, të cilët tani po qëllonin thuajse të gjitha pozicionet serbe. Meqenëse ende ishte pagëz dritë shifeshite tymi në distancë si dhe ndëgjoheshin krismat nga bombat e aviacionit të NATO-së. Nga të gjitha krismat që ndëgjoheshin më impresionuese për ne ishte krisma me Mavrick, B 1 dhe finalja me B 52 që na qetësonte (shpirtin) gjithëçka. Edhe sot bombardimet e NATO-së vazhduan deri në orët e herëshme pas mesnate.

Statusi i informatave të UÇK-së

(Kjo listë origjinale e caqeve për sulm është furnizuar nga Njësia Vëzhguese e UÇK-së, këtu nuk kemi paraqitë koordinata të sulmeve për arsye konfidenciale AE)

Situata e frontit të të dy palëve: të UÇK-së dhe armikut serb, kishte ndryshuar nga raporti i ditës së djeshme. Forcat serbe në 24 orët e fundit ishin nën presion prej bombardimeve të NATO-së, si dhe nga sulmet tona.

1- Informatat për armikun (serb)

Njësia e këmbësorisë së mekanizuar serbe, gjatë 24 orëve e cila ishte përforcuar me artileri dhe tanke, u qëllua shumë rëndë nga

aviacioni i NATO-së, prej së cilës kishin humbje të mëdha në ushtarë dhe në pajisjet e luftës sidomos në zonën e Gorozhupit, Mazrekut, Damjanit dhe Majën e Kurorës.

Për disa herë forcat e armikut u munduan që të zgjerojnë territorin e tyre duke u munduar që të shtyjej forcat tona (UÇK) në drejtim të kufirit të Shqipërisë. Sipas informatave të vëzhguesve mbrenda Kosovës, atyre (armikut) iu kishin ardhë forca të reja të motorizuara mekanike dhe po bëjnë përgaditjet për të na rrethuar. Sulmi i tyre mundë që të jetë në drejtim të Majës së Prodit, Majës së Pashtrikut, Planejës dhe Gorozhupit.

Gjatë luftimeve të datës 31 Maj 1999, forcat e Ruzhdi Saramatit, hapën zjarre me artileri, mortaja dhe raketa "Kaqusha" dhe i shkaktuan humbje të mëdha në njerëz armikut. Forcat e Ruzhdi Saramatit janë në linjën 700 metra në veri-lindje të Malit të Kurorës, në pjerrtësinë pa emër në afërsi të kufirit të Shqipërisë, rreth 1km. Në anën lindore të Malit të Pashtrikut në vazhdim lartë në veri të 3 shtëpive të Gorozhupit.

2- Informatat e forcave tona (UÇK-së)

Forcat e brigadës tonë më të re, pas luftimeve disa ditore duke luftuar me forcat e 3 batalioneve gjatë mbrëmjes së 31 Majit 1999 sollëm nga mbrendësia 1 batalion në gjendje gadishmërie që ta fusim në luftë herët në mëngjesin e 1 Qershorit 1999.

Sot gjatë ditës patëm disa shkëmbime zjarri në mes nesh (UÇK-së) dhe forcave të armikut. Në një situatë përderisa ishim mbledhur ushtarët tanë (UÇK-së) për të dreku, armiku kishte shfrytëzuar kohën e saktë dhe kishte sulmuar grupin tone të ushtarëve të (UÇK-së) të mbledhur me artileri dhe mortaja ku vrane 3 ushtarë tanë dhe plagosën 8 prej tyre. Ushtarët e lënduar rëndë u transferuan me helikopter për në Tiranë, kurse të tjerët e plagosur lehtë u transferuan në spitalin e Kukësit, ndërsa të vrarët janë në morgun e spitalit.

Forcat tona të UÇK-së po mbajnë linjën prej 700 metrave në veri-lindje të Malit Kunora, në afërsi të kufirit të Shqipërisë në pjerrtësinë pa emër, rreth 1 km. Ne anën lindorë të malit të Pashtrikut në vazhdim lartë në veri të 3 shtëpive të Gorozhupit.

3- Objektivat që kërkohen të sulmohen nga NATO-ja.

-Poslishte
-Gorozhup
-Planeja
-Ljubizhda
-Kushnin
-Në drejtim të rrugës prej Mazrekut për në Gorozhup
-Në drejtim të rrugës Dedaj për në Kushnin dhe
-Kryqëzimi i rrugëve"
(Me këto informata kemi edhe koordinatat e secilit vend)

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë kësaj dite aviacioni i NATO-së i shkatërroi armikut serb: 3 tanke, 13 armë artilerike, 12 autoblanda, 6 pozicione mortajash, 1 raketë lancues dhe automjete ushtarake. Nga bombardimet u qëlluan edhe oborri i trafës së energjisë elektrike, largëpërçuesi elektrik në afërsi të Beogradit, aeroporti i Batajnicës dhe Prishtinës, objektin dihmës të raketave tokë-ajër në afërsi të Beogradit, depot e municioneve në: Gjilan, Beograd, Sremska Mitrovicë, Kurshumli, Prishtinë, depot e karburantëve në Smederevë, Novi Sad dhe në aeroportin e Sjenicës, stacioni i karburantëve në Marash, depoja inxhinierike në Shabac, depot ushtarake në: Kragujevac, Titovo Uzhice dhe Ostruznice, shabti i MUP'it në Prishtinë si dhe kazerimat e Armatës së Jugosllavisë në: Novi Pazar, Leskovc, Pançevë, Beograd, Pejë, Gjilan dhe Obrenovac, kishte patur bombardime edhe në Novi Pazar si dhe në depon e armëve në Rashkë. Sot u bombardua edhe largëpërçuesi afër Obranovacit. Në qendrën e NATO-së në Mons të Belgjikës, sot gjithëashtu u bisedua nga 19 shtetet e Aleancës së NATO-së edhe për kërkesën e 50.000 trupave në rast për ndërhyrjen tokësore si dhe ruajtjen e paqës në Kosovë. Gjatë kësaj dite kemi edhe fjalët e Gjeneralit serb Vladimir Lazareviç i cili tha se Forcat e UÇK-së po ndihmohen edhe nga Forcat Ushtarake të Shqipërisë dhe për këtë arsye forcat serbe paskan sulmu me artileri vendbanimet shqiptare mbrenda dhe për rreth kufirit të Shqipërisë, ku kishte disa nga popullata civile të vrarë dhe të plagosur.

Deri më sot nga Kosova ishin larguar dhe ishin strehuar në Shqipëri 442,400 refugjatë, kurse në Maqedoni kishin shkuar mbi 249,300, në Mal të Zi 67,600 dhe në Bosnjë-Hercegovinë rreth 21,700 refugjatë. Numri total i refugjatëve nga Kosova në këtë rajon ishte rreth 781,000. Prej këtyre refugjatëve ishin evakuuar për në Gjermani 72,000, për në Turqi 13,250, për në Norvegji 5,951, për në Itali 5,829, për në Kanadë 5,154, dhe Amerikë 4,894.

E martë, 1 qershor 1999

Rreth orës 7:00 e mëngjesit, më erdhi njëri prej pjesëtarëve të Forcave të Policisë Usharake të Shqipërisë, të cilët ishin të vendosur në anën tjetër po të njejtit objekt ku ishim edhe ne, edhe m'u drejtua mua, edhe pse me shumicën prej tyre tani njëfeshim për një kohë të gjatë prej kur që ishim edhe ne aty, i cili më pyeti se a quhesh Ajaz Emin, unë i thash: "Po, pse ç'kemi të re?" ai më thotë: "Tani sa dëgjova nëpërmjet të Radio Dojçe Velle's se po të kërkojnë familjarët e tu që të lajmërohesh sa më shpejtë, sepse nuk e dijnë se ku gjindesh edhe ishin bërë shumë merak për ty, dhe të kanë shpallë si të humbur!" U habita për vete se kush mundë të më kërkon, sepse e dija se bashkëshortja Shahadija është ende në Amerikë edhe e din se ku

jam unë, edhe e din gjendjen shumë mirë?! Me kalimin e kohës më vonë mora vesh se më kishte kërkuar dhëndërrin im Sabri Hasani, nga fshati Çerkez i Kumanovës, sepse ai me motrën time Nergjizen e dinin se kam ardhë diku në Shqipëri me Forcat e Armatës Amerikane, por nuk dinin se si isha dhe ku isha! Gjatë kësaj kohe radio stacionet e ndryshme, kishin marrë për sipër që të bëjnë njoftime në lidhje për gjetjen e familjarëve të refugjatëve të humbur nga Kosova në mes vete, sepse shumica e tyre gjatë dëbimit ishin ndarë nga forcat serbe, dhe disa prej tyre i kishin përzier: disa për në Maqedoni, dhe të tjerët pjesëtarë të po të njejtës familje i dëbojnë për në Shqipëri e disa të tjerë në Mal të Zi. Kishte raste kur edhe fëmijët e një familje ishin ndarë, disa fëmijë ishin përcjellë në një shtet, e të tjerët në shtetin tjetër!

Edhe sot filluam punën qysh herët në mëngjes, dhe në orën 9:00 shkuam për të takuar Gjeneralin Lama në zyrën e tij, si dhe për të biseduar për listën e objektivave më të reja që i kanë arritur nga grupi vëzhgues i Shtabit të UÇK-së prej mbrenda Kosovës. Nga qendra jonë e shtabit ushtarak në Rinas, tani në mënyrë permanente po na kërkoheshin caqet e reja me qëllim që menjëherë të sulmoheshin nga aviacioni i NATO-së. Pas marrjes së listës së objektivave të reja, Gjenerali Lama na njoftoi se mbrëmë rreth mëngjesit ishin sulmuar gabimisht prej aviacionit të NATO-së edhe forcat e Ushtrisë së Shqipërisë, mbrenda kufirit shqiptar! Nga sulmet e NATO-së 3 bunkera afër kufirit me Shqipëri-Kosovë ishin ngritë në ajër, që donë të thotë se ishin nxjerrë krejtësisht prej tokës nga bombardimi, por siç i kishte parë edhe ishte informuar edhe vetë Gjenerali Lama na tha se nuk kishte ndonjë të vrarë apo të lënduar, sepse për fat të mirë në momentin e bombardimit nuk kishte qëlluar asnjëri nga pjesëtarët ushtarak mbrenda tyre, dhe ky ishte fati që nuk kishte pasë të vrarë apo të plagosur!

Pas këtij takimi u larguam për në zyrën tonë, mirëpo më vonë përsëri na u dëshetë që edhe 3 herë ta marrim të njejtën rrugë për në zyrën e Gjeneralit Kudusi Lama, një rrugë të cilën po sa e bëmë e sa më duket se ishte e mjaftueshme për sot. Por, edhe nuk është për t'u çuditur, mundë të na ndodhë që të shkojë përsëri nëse e don puna, sepse ne jemi të përkushtur që ta kryejmë këtë punë me plotë dëshirë sa herë që e don nevoja, që sa më shpejtë të shkatërojmë armikun gjakatarë serb. Sa herë që të jetë nevoja ne jemi të gatshëm që ta hecim përsëri këtë rrugicë, veçse që t'ia arrijmë qëllimit tonë dhe të gjithë popullit shqipëtarë dhe miqëve tanë të Forcave Amerikane dhe NATO's, dhe sa herë që duhet ne do të shkojmë me shpejtësi dhe të sjellim koordinatat më të reja të sulmit kundër këtij armiku të përbashkët.

Pas dite, në orën 14:00 ia arriti te ne edhe Gjenerali Amerikan John Hendrix, të cilin thuajse tani veçse e kishim visitor të rregullt dhe mjaftë të shpeshtë. Për



05 Gusht 1999, në gjykatën e parë të Kosovës së Lirë me Kapitenin Jurist Charles J. Kovats, Jr. në Kampin ushtarak Amerikan "Bondsteel" / Kosovë

takimin me Gjeneralin Hendrix e ftuam edhe Gjeneralin Lama, i cili asnjëherë nuk pritoi, por gjithëmonë ishte i gatshëm që në çfarëdo kohe qoftë që në mënyrë pozitive t'i përgjigjej ftesave tona, i cili edhe kësaj here erdhi menjëherë, dhe takimin e zhvilluam në zyrën tonë, aty ku u bisedua për planet e mëtejme të luftimeve. Përderisa ishim duke biseduar, në ndërkohë e lajmëruan Gjeneralin Lama nga stafi i tij se përsëri paska pasë sulm nga bombarduesit e NATO-së mbrenda kufirit të Shqipërisë, afër pikës kufitare të Morinës! Sulmet ishin bërë nga 6 aeroplanë të NATO-së, për çka që të gjithë ne patëm një shqetësim të madhë, e në veçanti u preknë më së shumti nga ky akt i shëmtuar Gjenerali Hendrix dhe Gjenerali Lama. Gjenerali Hendrix ishte i shqetësuar më së tepërmi, shqetësimi tek i cili vërehej shumë lehtë edhe në fytyrën e tij, kurse Gjenerali Lama mundahej ta zbusë gjendjen, dhe që ta qetësojë mllëfin e Gjeneralit Hendrix për këto gabime që sa po ishin bërë edhe ishin të pa falshme. Për këtë gjenerali Amerikan po i bënte pyetje vetëve se si mundë të ndodhë diçka e tillë!

Gjenerali Hendrix kësaj here me vete na kishte sjellë edhe një telefon satelitor, për çka e mbajti fjalën e premtimit të dhënë para disa ditësh, për të na e mundësuar bisedën tonë me më të dashurit, familjarët tanë, të cilin menjëherë e mori Kapiteni Wiggis edhe së pari ma dha mua që t'i telefonoj familjes time në Amerikë. Telefonova Shahadijen e cila ishte bërë shumë merak, se ç'po ndodhte me ne pa kurrëfarë lidhesh, sepse nga shumë lajme të këqia nga terreni që kishte parë në televizionin dhe mediat amerikane, që në përgjithësi ishin lajme jo të mira! Bisedën nuk e zgjata shumë sepse po pritnin edhe kolegët tjerë, dhe pas disa minutash ia dhashë shokëve të tjerë telefonin që edhe ata të ndëgjohen me të dashurit e tyre. Pas takimit, që të dy Gjeneralët u larguan secili në drejtimin e vetë, Gjenerali Hendrix me helikopter dhe entarazhën e tij u largua për në kampin ushtarak të Rinasit, kurse Gjenerali Lama iku për në

zyrën e tij.

Bombardimet vazhduan të ndëgjohen deri vonë gjatë mbrëmjes, edhe pse ishte koha jo e volitshme, kishte shi dhe mjegull çka e pengonte shpeshherë aksionin e aviacionit të NATO-së dhe pas qetësimit të kohës puna jonë ishte në rritje edhe më intensive sepse na kërkoheshin gjithnjë e më tepër objektiva të reja nga shtabi jonë amerikan në Rinas afër Tiranës.

"Situata informative e orës 10:00 të datës 01-06-1999**(Lista origjinale e UÇK-së pa koordinata për arsye konfidenciale AE)**

1. Nga të dhënat e zbulimit në rajonet e ndryshme në thellësi, forcat serbe kanë filluar lëvizjet e reja duke u përqëndruar përballë forcave tona për të kaluar në ofenzivë të pjesëshme. Këto forca përbëhen kryesisht nga repartet dhe nënrepartet e këmbësorisë, artilerisë e mortajave dhe atyre tankiste.

2. Duke u nisur nga mendimi i mësipër, objektet e mundëshme ku NATO-së mundë të godasë me aviacion janë sipas të dhënave të më poshtme.

-Pozharin

-Glogjan

-Irnziq

-Shaptej, forca të cilat janë përqëndruar dhe veprojnë aktualisht.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë kësaj dite kishte mbi 300 fluturime të aviacionit të NATO's. Aeroplanët luftarak të aleancës së NATO -së, kryesisht sulmuan edhe infrastrukturën mbrenda ish Jugosllavisë, dhe sidomos për rreth kufirit Kosovë-Shqipëri. Zëdhënësi i NATO's Jamies Shea përsëriti se: "NATO NUK KA LIDHJE DIREKTE ME UÇK-NË, POR KEMI BENEFICIONE INDIREKTE PREJ SAJË! (Kjo ishte ajo lidhja jonë indirekte)" në akcionet tona. Sipas raporteve të medias jugosllave thuhet se kishte mbi 40 civil të vrarë gjatë vikendit. Të

dielën herët, aviacioni i NATO's bombardoi urën, ku derisa popullata civile po kthehej nga pazari, ku mendohet se u vranë më së paku 9 prej tyre. Të hënën, raportohet se në jug të Serbisë aviacioni i NATO-së kishte qëlluar një spital dhe një shtëpi të pleqëve, për ku thuhet se u vranë mëse 27 njerëz të popullatës civile.

Gjatë kësaj dite u bisedua edhe për numrin prej 50000 ushtarësh që do të marrin pjesë në forcat paqëruajtëse të KFOR-it.

Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-së Cohen tha se po të kishin qenë veçse sulmet e aviacionit të SHBA-së do të kishte qenë një mënyrë krejt ndryshe nga kjo e tanishmja, ne do të sulmonim në gjerësi më të madhe dhe më të shumta sipas mendimit tim.

Nga pala serbe u paraqit Gjenerali i Armatës Jugosllave Vladimir Lazareviç, i cili tha se UÇK-ja po ndihmohet nga Armata e Shqipërisë, prej nga forcat e saja kanë hyrë në aradhat e UÇK-së. Dje Armata Jugosllave shkatërroi pikën kufitare në Pogaj ku kishte qëlluar edhe fshatrat shqiptare përtej kufirit, ku kishte edhe të vrarë prej nga u tërhoqën edhe forcat e UÇK-së në mbrendësi të Kukësit. Po, sepse aty ishin të koncentruar më se 100.000 refugjatë kosovarë.

Sipas agjencisë së refugjatëve UNHC thuhet se deri më tani kishin arritë në Shqipëri mbi 442.400 refugjatë, në Maqedoni mbi 249.300 refugjatë, në Mal të Zi mbi 67.000 refugjatë dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë 21.700 refugjatë. Numri i përgjithshëm i refugjatëve Kosovar në këtë regjion kishte arritur mbi 781.000 refugjatë, kurse prej tyre ishin evakuuar mbi 72.000.

Gjermania kishte marrë 13.250 refugjatë, Turqia kishte marrë 7.475 refugjatë, Norvegjia kishte marrë 5.951 refugjatë, Kanadaja kishte marrë 5.154 refugjatë kurse SHBA'ja kishte marrë 4.984 refugjatë.

Ministri i punëve të jashtëme të ish Jugosllavisë kërkoi që sulmet ajrore të NATO's të ndërprehen para se të pranohet plani i paqes. Gjithashtu edhe ministri rus ia paraqiti Beogradit verzionin e planit të G8...

E mërkurë, 02 qershor 1999

Këtë ditë e filluam shumë më herët se zakonisht, donë të thotë aty rreth orës 2:30 pas mesnate, kur erdhi dhe më zgjoi nga gjumi Kapiteni Wiggis për përkthimin dhe verifikimin e emrave nga lista e objektivave të reja që ishin kërkuar nga Shtabi Qendror në Rinas për ta ditë ende më saktësisht se a mos kishte në afërsi të këtyre objektivave edhe pjesëtarë të UÇK-së si dhe ndonjë pjesë të popullatës civile Kosovare. Në orën 2:30 të mëngjesit i telefonova Gjeneralit Kudusi Lama që edhe njëherë të bëhet vërtetimi se a mos kishte ndonjë pjesëtarë të UÇK-së si dhe të popullatës civile për rreth këtyre objektivave para se të bëhet sulmi bombardues i avionit të NATO-së. Gjenerali Lama përsëri na e dha dritën e gjelbërt, dhe se në çdo kohë këto pika mundën që të sulmohen nga avioni i NATO-së dhe të kryenim punën e tyre. Pas bisedës me Gjeneralin Lama, Kapiteni Wiggis përsëri e mori në radio-lidhjet e tij Shtabin Amerikan në Rinas dhe i tha se terreni ishte i pastërt nga pjestarët e UÇK-së dhe nga popullata civile si dhe sulmi mundë të kryhet në çdo moment. Në orën 9:00 të mëngjesit shkua në zyrën e Gjeneralit Lama në takimin e rregullt që kishim si çdo herë, që të marrim dhe verifikojmë caqet më të reja të sulmit mbi forcat e armikut serb. Objektivat primare që verifikuam dhe morëm, ishin ato ku forcat serbe kishin rrethuar dhe po sulmonin popullatën civile dhe forcat e UÇK-së në thellësi të mbrendisë në rajonin e Cërnavës. Caqet të reja kishim edhe për në Malishevë e deri në Llapushnik, ku forcat e armikut kërkoheshin dhe duhej sulmuar pa kurrëfarë mëshire. Në orën 16:00 pas dite, na lajmëruan se veçësë kishin filluar bombardimet e avionit të NATO-së dhe siç kuptuam nëpërmjet Gjeneralit Lama nga lidhjet e tij me shtabin e UÇK-së, bombardimet e sotme ishin shumë më të suksesëshme, të cilat i paskan shkaktuar humbje të mëdha armikut serb në ushtarë dhe mjete luftarake. Lajm që ne e pritëm me shumë entuziazëm dhe kërenari i gjithë grupi ynë në Kukës! Dikur më vonë, rreth orës 20:00 të mbrëmjes më mori në telefon Gjenerali Lama dhe më thotë se duhet lajmëruar Shtabin Amerikan në Rinas që për menjëherë të ndërpresin të gjitha sulmet ajrore të NATO's sepse na qenkan bombarduar gabimisht edhe popullata civile mbrenda Cërnavës, ku na qenkan të përqendruar mëse 100,000 njerëz së bashku me forcat e UÇK-së. Gjenerali Lama ishte tepër i mërzitur dhe dëshpëruar nga këto gabime të avionit të NATO-së edhe pse kishim patur shumë suksese këtyre ditëve të fundit, mirëpo edhe na ishin bërë disa gabime ku u sulmuar pjesëtarët e UÇK-së si dhe sulmi i NATO-së për mbrenda kufirit të Shqipërisë, gabime që nuk na faleshin kurrë. Që të gjithë pajtohemi me Gjeneralin sepse kishte plotë të drejtë, sepse jeta e njeriut është e pa kthyeshme! Gjatë ditës së sotme patëm edhe disa sulme nga forcat serbe mbrenda kufirit të

Shqipërisë, diku në afërsi të Tropojës. Për këtë sulm të forcave serbe Gjenerali Lama kishte dhënë urdhërin që Forcat Ushtarake të Shqipërisë t'i kundërpërgjigjen me zjarr topash, për shkak se trupat serbe ishin futë mbrenda një fshati kufitar edhe ia kishin dhënë zjarrin dy shtëpive të fshatarëve. Sot gjithashtu ishin zhvilluar luftime të rrepta në mes të UÇK-së dhe armikut serb edhe në Malin e Pashtrikut, ku ende po bëhej një luftë e rreptë për ta marrë këtë pikë shumë strategjike dhe shumë të rëndësishme, nga të cilat luftime ndëgjohej krisma armësh edhe këtu te ne në afërsi të Kukësit. Përballë neve, në malet e Pashtrikut ku shifej pluhuri nga granatimet dhe ndëgjohehin krisma e gjuajtjesh me mortaja dhe artileri.

Gjenerali Kudusi Lama sot më uroi për punën e mirë që po bëja, si dhe më tha; "Kjo punë e ytja është një detyrë shumë e rëndësishme, këtë punë që po bënë ti është shumë më tepër se një pushkë në frontin e luftës, mundohu sa më tepër të korrigjosh edhe punën e të tjerëve!" Me grupin që po punoja me të vërtetë kisha respekt të vacantë të cilët edhe ma dinin rëndësinë, jo vetëm se isha përkthyes por në një mënyrë isha dhe bëja punën edhe të një këshilltari shumë të mirë, për çka shumë herë edhe mu fale-minderuan dhe më shkruajtën edhe letra rekomanduese për në të ardhmen. I gjithë grupi për gjithëçka pikësëpari më drejttoheshin mua, sepse për shumë gjëra unë kisha shumë më tepër njohuri se sa ata. Me grupet e më parme që punova si me thënë, mora eksperiencë shumë dimensionale, edhe tani kur mësova shumicën e terminologjisë ushtarake isha bërë gati si një ushtarë i rregullt dhe me përvojë të madhe, edhe detyrat ushtarake më sekrete që kishim ata tani po i shkëmbeuam me mua!

Gjenerali Lama tani kishte një besim të madhë tek unë, edhe mu lutë që herave tjera kur të ketë takime me Gjeneralin Hendrix më kërkoi që unë të jemë përkthyes i tyre, sepse ai kishte dyshim, edhe më tha: "Përkthyesja e Gjeneralit Hendrix, Sebi (Sebi-hatja) ishte e

lindur në Amerikë dhe nuk e njihka sa duhet gjuhën shqipe, dhe shumë herë po kam problem dhe nuk po mundem që ta kuptoj se çka po përkthen!" Unë iu përgjigja: "Këtë gjë unë nuk mundë ta bëjë, por nëse doni ju ashtu, i thuaj Kapitenit Wiggis edhe ai i thotë Gjeneralit Hendrix, sepse ne jemi shokë dhe nuk ma lejon karakteri im, pastaj neve na cakton tjetërkush se ku duhet të punojmë. Për momentin mua më kanë caktuar që të jemë përkthyes i Kapitenit Wiggis me juve, dhe për këtë ku të ketë nevojë kapiteni, unë do të jem aty."

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sot u bënë 70 ditë që nga fillimi i bombardimeve të NATO-së. Gjatë kësaj kohe kemi pasë më tepër se 31,000 sulme ajrore, dhe nga informatat e dhanura të Shtabit Qendrorë të NATO-së në Bruksel, deri më sot i kishim shkatërruar armikut serb: 120 tanksa, 203 auto blinda edhe 314 armë artilerike, me gjithësej 30% të mjeteve luftarake që kishte ushtria jugosllave mbrenda Kosovës. Nga sulmet e NATO-së u shkatërruan apo dëmtuan mëse 100 aeroplanë të armikut, 40% e rezervave të karburantit ushtarak serb, 57% e rezervave të përbashkëta ushtarako-civile, 29% të rezervave të municionit dhe 45 urave. Komanda e tretë e Armatës amerikane tha se kishte të vrarë mëse 1800 ushtarë që nga fillimi i kampanjës ajrore të NATO-së në arenën e "Operacionit të Forcave Aleate".

Në afërsi të Prizrenit luftimet në mes të UÇK-së dhe forcave serbe ende po vazhdonin dhe ku UÇK-ja i kishte shkatërruar një pjesë të artilerisë dhe auto-blindave të armikut. Gjithashtu edhe sulmet e NATO-së kishin vazhduar edhe më tej edhe i kishin shkatërruar një numër të madhë të artilerisë dhe disa auto-blindave që ishin gjetur hapur në natyrë dhe i kishin vrarë një Gjeneral të rangut të lartë serb.

Sipas marrëveshjes, Britania e Madhe tani kishte vu në gjendje gadishmërie 12,000 ushtarë që për çfarëdo rasti t'i bashkangjiten

atyre të NATO-së sa ishin 5300 në Maqedoni, si dhe Franca i kishte ofruar 7000 trupa dhe Italia që kishte tani në Shqipëri 8000 ushtarët e sajë do t'ia bashkangjese atyre në Maqedoni sipas nevojës. Gjatë ditës së sotme edhe Ahtisaari ishte nisë për në Beograd, që edhe njëherë t'ia paraqesë dhe t'ia bëjë me dije rolin e NATO-së, presidentit serb Millosheviqit.

Sot gjithëashtu ishte refuzuar ankesa serbe për sulmin e kampanjës ajrore të NATO-së kundër tyre edhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Po në të njëjtën ditë ishte raportuar se Presidenti Clinton do të takohet nesër për të biseduar për opcionin e trupave të këmbësorisë me Shefin e Përbashkët të Ushtrisë Amerikane.

Gjithëashtu edhe Sekretarësja e SHBA'së Albright, gjatë takimit të sajë me Ministrin e Punëve të Jashtme të Italisë Dini i kishte thënë se sipas marrëveshjes së NATO's trupave jugosllave i jipet rreth një javë kohë për t'u tërheqë krejtësisht nga Kosova, para se të arrihet paqja e ndërprejes së zjarrit. Pas 70 ditëve të Operacionit të Forcave Aleate kishim mbi 31.000 fluturime sulmi të avionit të NATO-së, për çka raportohet se kishin shkatërruar: 120 tanke, 203 autoblanda, 314 mjete të artilerisë, që donë të thotë se ishin shkatërruar mbi 30% të mjeteve të Armatës së Jugosllavisë. Gjatë këtyre operacioneve u shkatërruan apo dëmtuar edhe 100 aeroplanë, 40% të rezervave të karburantëve të ushtrisë, 57% të rezervistave civilo-ushtarak, 29% e depove të municionit dhe 45 urave.

Sot gjithëashtu bëhet e ditur se ishte vrarë edhe një Gjeneral i forcave jugosllave, mirëpo nuk dihet se a u vra nga luftimet me UÇK-në apo nga bombardimet e NATO's. Rreth Prizrenit në jug të Kosovës ende kishin vazhduar luftimet në mes të UÇK-së dhe forcave jugosllave.

Sipas zëdhënësit të NATO-së u tha se deri më tani kemi siguruar për forcat paqëruajtëse të KFOR-it nga; Britania 12.000 trupa të këmbësorisë që ishin të gatshëm t'iu bashkoheshin atyre 5.300 sa i

kishin në Maqedoni, Franca iu kishte ofruar 7.000 trupa, kurse Italia i kishte ofruar 8.000 trupa të cilët veçësë i kishte në Shqipëri.

Sipas UNHCR-së numri i refugjatëve kishte arritë në Shqipëri në 442.600, kishin arritë në Maqedoni 248.900, në Mal të Zi 68.400 edhe 21.700 në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Sekretarja e Shtetit Albright kishte mbledhje me Ministrin e Punëve të Jashtme të Italisë Dini, dhe tha se sipas pikave të marrëveshjes forcat jugosllave duhet të largohen nga Kosova, para se të hyjë në fuqi marrëveshja e paqës...

E enjte 03 qershor 1999

Sot e filluam një ditë të re, po shifet se edhe Parlamenti i Serbisë më në fund u bind se nuk kanë rrugëdalje tjetër përveçësë DORËZIMIT, tani sa paskan votuar për pajtim në të gjitha pikat e kërkesave të Aleancës së NATO-së. Tani neve na mbetet të presim edhe të shofim se për çfarë paqe po mirren vesh! Edhe pse Presidenti serb Slobodan Millosheviq i pranoi të gjitha pikat e NATO-së, nuk donë të thotë se bombardimet do të ndërprehen menjëherë, ato do të vazhdojnë për derisa të jenë në Kosovë trupat gjakatare paramilitaro ushtarako policore sllave të Serbisë!

Takimi me Gjeneralin Lama ishte i zakonshëm, i njëjtë sikurëse ditëve të më herëshme. Edhe ai nuk ishte aspak optimist se do të ketë diçka me rëndësi me këtë paqe që kinse ishte arritur, pasi se dihet se edhe shumë herë Presidenti Serb Millosheviq i kishte premtu me të njëjtat rrena!

Luftimet e rrepta ishin zhvillu edhe sot, edhe atë në disa fronte në mes të UÇK-së dhe forcave serbe, por luftimet më të mëdhaja tani po zhvilloheshin për kontrollin e pikave strategjike në malet e Pashtrikut, ku edhe ishin të përqendruara bombardimet e avionit të NATO-së, me qëllim që të shpërthejnë frontin e bunkertë serb. Sot përsëri nga Forcat e Avionit të NATO-së u bombarduan: Verbnica, Pla- neja si dhe Zhuri.

Nga Gjenerali Lama u kërkua që të sulmohet edhe fronti tjetër i serbëve, ai rreth Grykës së Cërnavës ku ishte i rrethuar një numër i madh i popullatës civile shqiptare si dhe të forcave të UÇK-së. Për këtë zonë Gjenerali Lama tani na kërkoi që këto caqe të jenë primare për bombardimet e ardhëshme të avionit të NATO's, si dhe këto ishin edhe kërkesat primare nga Gjenerali i UÇK-së Agim Çeku.

Disa fjalë shtojcë për Gjeneralin Agim Çekun: e gjithë puna që po bënim në lidhje me lëvizjet dhe pikat strategjike të armikut serb na ishin dhanun nga njësia vëzhguese e UÇK-së, që nga fillimi edhe që të gjitha sulmet e deritanishme mbi forcat serbe ishin krejtësisht nën direktivat e tij, por kuptohet si dhe me ndërmjetësinë tonë Gjeneralin Kudusi Lama, Komandant i Divizionit Ushtarak të Shqipërisë këtu në Kukës, i cili ishte edhe ndërmjetësuesi dhe ndihma kryesore e njësisë tonë!

Gjenerali Agim Çeku ishte një burrë në të dyzetat, i cili kishte



17 Qershor 1999 Sojeve /Kosovë, në këtë shtëpi kaluam natën e parë në Kosovën e Lirë me të njëjtën Njësi Speciale Amerikane nga Kukësi në Shqipëri.

shërbyer si pjesëtarë në komandën e Armatës së Jugosllavisë dhe që njihet shumë nga qarqet kroate të luftës si ideatori kryesorë në aksionin e betejës së njohur Kroate "Olluja". Kjo betejë ishte ajo e cila ishte vendimtare për thyerjen e ushtrisë jugosllave në Kroaci, për çka më vonë Gjeneral Çeku edhe shpërblehet me gradat më të larta edhe nga vetë kryetari i Kroacisë Tuxhman, për heroizmin dhe taktikën ushtarake që tregoi në atë betejë, por kup-tohet edhe nga betejat tjera të Kroacisë ku kishte qenë pjesëmarrës.

Gjeneral Çeku kishte eksperiencë dhe njohuri shumë të mira se si funksionon ushtria jugosllave. Çeku kishte marrë pjesë direkte kundër forcave serbo-jugosllave edhe në luftën e Bosnës dhe Hercegovinës, ku ishte mjaftë i suksesëshëm edhe në ato luftëra. Me eksperiencën që kishte kundër të njejtit armik serb, Gjeneral Agim Çekut edhe në Kosovë iu besua pozita e tij në krye të UÇK-së ku po tregohej mjaftë i suksesëshëm. Me Gjeneral Agim Çekun në luftën e Kosovës, tani kishte edhe një numër të madhë të ushtarakëve me grada të ndryshme që kishin ardhë nga Kroacia, Bosna dhe Hercegovina, Sllovenia dhe vendet tjera Evropiane, të cilët iu kishin bashkangjitur aradhave të UÇK-së. Po pra, për të luftuar krahë vëllezërve dhe motrave shqiptare kundër armikut fashist serb, ku edhe u treguan mjaftë të suksesëshëm në çlirimin e Kosovës.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme kishim mbi 644 fluturime të aviacionit të NATO-së duke vazhduar me bombardimin e pistave të aeroportëve të ndryshme, pikat komunikuese si dhe mbi forcat serbe për rreth kufirit Shqipëri-Kosovë. Sot nuk kishte bombardime në Beograd, mirëpo kishte një bombardim të gabueshëm në mbrendi të teritorit të Shqipërisë, dhe për fat pa viktimë. Në Beograd në mëngjesin e sotëm përsëri kishin vazhduar bisedimet në mes të Presidentit Slobodan Millosheviqit me Ahtisaarin dhe envojit rus Chernomyrdin, i cili i kishte paraqitë planin e shteteve të G 8. Po, pasi se Millosheviq kishte pranuar planin e tyre. Tani Ahtisaari ishte nisë për në Samitin në Cologne të Gjermanisë, për t'a çfaqë marrëveshjen e arritur. Plani ishte gjithëashtu që me fillimin e tërheqjes së trupave serbe të bëhet edhe ndërpreja e sulmeve të NATO-së. Në Maqedoni Kryeministri i tyre Georgievski ishte pajtuar që në shtetin e tij të mundë të hyjnë 30,000 trupat e NATO-së për parapërgatitje para se të hyjnë në Kosovë.

Në Washington ishin takuar edhe Presidenti Clinton me Sekretarin e Mbrojtjes Cohen (Kohen) si dhe Shefin e Përgjithshëm për planin e zbarkimit të KFOR-it në Kosovë dhe me marrëveshje që të gjitha forcat paqëruajtëse me qenë nën kontrollin e NATO-së.

Sipas UNHC- së thuhet se gjerë më sot numri i refugjatëve në shtetet fqinje kishte arritur në

gjithësejt 782.100, duke përfshirë Shqipërinë me 443.100 refugjatë, Maqedonia me 248.400 refugjatë, në Mal të Zi me 68.900 refugjatë dhe Bosna dhe Hercegovina me 21.700 refugjatë.

Presidenti Clinton tha dje, se ishte i gatshëm që të dërgojë në Kosovë 7.000 ushtarë si forca paqëruajtëse, që donë të thotë 15% nga totali i forcave paqëruajtëse në teren. Gjithëashtu Presidenti Clinton së bashku me Sekretarin e Mbrojtjes Cohen dhe Shefin e Shtabit do të takoheshin për të biseduar për të ardhmen e kampanjës ajrore si dhe përgaditjet për zbarkimin e KFOR-it në Kosovë.

Sipas Ministrit të Jashtëm të Britanisë Robin Cook, sipas planit të forcave të NATO-së ato duhet të vendosen në çdo cep të Kosovës dhe duhet që pa tjetër që të gjithë forcat paqëruajtëse duhet të udhëhiqen vetëmse nga komanda e NATO-së...

E premte 04 qershor 1999

Ende pa u zgjuar aty para orës 7:00 të mëngjesit, më erdhi njëri nga personeli i Policisë Ushtarake të Shqipërisë që të më ftojë për një thirrje telefonike që kisha nga Gjenerali Lama. Menjëherë u zgjova dhe shkova në anën tjetër të objektit, në zyrën e Policisë Ushtarake që ta ndëgjojë Gjeneralin në telefon se pse më kërkon. Posa hyra në zyrën e tyre menjëherë personeli na e bëri lidhjen telefonike me Gjeneralin me të cilin filluam të bisedojmë, dhe që në fillim në bazë të bisedës shifë se gjenerali ishte diçka shumë i mërzitur. Në bisedë e sipër më tregoi se ishte shumë i pikëlluar se pse caqet e sulmit që na i kishte dhënë neve para 3 ditëve ende nuk ishte ndërmarrë kurrë- farë akcioni nga bombarduesit e NATO-së. Dhe sipas fjalëve të tij tani shumëçka ishte në rrezik, si dhe jeta e popullatës dhe shumë pjesëtarëve të UÇK-së. Gjatë bisedës caktuam një orar të rregullt që çdo ditë të takohemi së bashku në orën 9:00 të mëngjesit si edhe pas dite në orën 17:00, që të bisedojmë edhe më gjërësisht për pikat e reja të sulmeve sepse do të kishim më tepër kohë. Nga ky orar, nuk donë të thotë se nuk mundë të kemi kontakte edhe më të shpeshta poqëse nevoitej. Ne ishim të gatshëm që çdo herë të ishim në kontakt me Gjeneralin Lama, si dhe për çfarëdo lëvizje që të hotohej nga ana e palës së armikut serb, apo edhe asajë të UÇK-së, të na bëhej e ditur që në një mënyrë të kemi një pasqyrë të qartë të çfarëdo aksioni që të ndërmerrim, se ku dhe kurë duhej sulmuar dhe se çka duhej sulmuar. Gjatë bisedës që bëjmë, iu luta Gjeneralit që poqëse ka mundësi të vijmë edhe të takohemi tani pas disa orësh që t'i sqarojmë të gjitha gjërat së bashku. Me propozimin tim u pajtua edhe Gjenerali Lama edhe atë pa kurrëfarë hezitimi. Përsëri më tha do të takohemi por nuk e di që se si t'ia bëjmë dhe ç'të bëjmë sepse kemi një numër të madh të popullatës në rrezik, por gjithashtu edhe forcat e UÇK-së, e bile edhe vetë Shtabin e UÇK-së e kemi në rrezik për shkak të sulmeve të



04 Tetor 1999, Sojevë /Kosovë, me Gjeneralet e TMK-së Refki Suma dhe Shaban Shala

rrepta që ka ndërmarrë armiku serb. Pas përfundimit të bisedës u ktheva te njësia ime dhe pas një kohe unë dhe Kapiteni Wiggis u nisëm dhe shkuaam në zyrën e Gjeneralit Lama. Mirëpo para shkuarjes i sqarova kapitenit edhe për pikëllimin e tij, edhe e pyeta direkt atë se pse po na ndodhin këso farë gabimesh apo injorimesh pasi t'i japim objektivat e verifikuara, si mundet të lihen anash dhe mos të ekzekutohen? Përgjigjeja e Kapitenit Wiggis ishte se nga Shtabi Ushtarak Amerikan në Rinas i kishin lajmëruar kapitenit se gjendja në teren nuk është e saktë ashtu siç po na e paraqet Gjenerali Lama, dhe sipas burimeve dhe informatave tjera Amerikane, si ato të CIA's që kishin njerëzit e tyre në teren, ata po i jepnin informata pak më ndryshe Gjeneralit Hendrix. Mirëpo kapiteni Wiggis më porositi që mos t'i themi asgjë Gjeneralit Lama në lidhje me këtë që sapo të tregova, sepse të gjitha gjërat nuk bënë të dihen, dhe mos ta rëndojmë njëri tjetrin duke e akuzuar për të pa vërtetat.

Sipas fjalëve të Komandantit Wiggis, mendon se dikush nuk po e tregon të vërtetën sa duhet, dhe objektivat që ia kanë dhënë Gjeneralit Lama ato nuk janë të plota tërësisht!

Pasi arritëm në zyrën e Gjeneralit, si zakonisht u përshëndetëm sikur të mos kishte ndodhur asgjë edhe u ulëm rreth tavolinës së tijë përballë. Që në fillim të bisedës Kapiteni Wiggis më tha t'i sqarojmë Gjeneralit Lama për misionin tonë, dhe çdo gjë siç na kishte thënë ashtu edhe i bëjmë prioritetet tona të bombardimeve, mirëpo nga ana e NATO-së pasqyra reale ishte diçka më ndryshe. Prioriteti sipas NATO-së ishin caqet e sulmit mbi forcat serbe në Koshare, për ku edhe në rast të ndërhyrjes sonë të këmbësorisë të kemi shtegun sa më të lirë dhe të hapur, dhe m'u për atë na duhet pastruar koridorin nga Shqipëria nëpërmes të Koshares për me pasë dalje deri në Zhur. Për këtë sulm të Kosharës ishte dhënë urdhëri që të sulmohet masovikisht duke përdorë edhe bombarduesit më të mëdhenjë B-52, të cilët veçëse kishin sulmuar tani disa herë

Verbnicën, Planejën dhe Zhurin, për çka besohet se aty pala e armikut serb kishte pasë humbje të mëdha në ushtarë dhe teknikë ushtarake. Sulmi tjetër që ishte si pikë prioritare ishte edhe ajo në koridorin e Junikut dhe Rrasës së Zogut. Biseda e më tejme përsëri u përqëndrua nga Gjenerali për pozitën e rëndë të popullatës civile dhe të pjesëtarëve të UÇK-së në malet e Cërnalevës. Sipas fjalëve të Gjeneralit Lama gjendja e UÇK-së në këtë rajon ishte tepër e rëndë, dhe nëse nuk bëhet asgjë me intervenime nga bombardimet e aviacionit të NATO's ushtria e UÇK-së do të ketë humbje katastrofale! Gjenerali më tha: "Nuk e di që se çka t'ju them, por sidoqoftë për mua, do të jetë tepër e vështirë që të ballafaqohem dhe të bashkëpunojmë me Shtabin e UÇK-së. Gjatë bisedës, disa herë Gjeneralit iu mbushën sytë me lotë, për shkak të pa mundësisë për t'a ndihmuar gjendjen e Cërnalevës, për çka edhe unë u emocionova tej mase. Edhe mua më pikuan lotët nga dhimbja për ata të rinjë që po sakrifikonin edhe jetën e tyre e që nuk kursenin asgjë për lirinë e Kosovës, sepse lotët e Gjeneralit Lama po më tregonin diçka shumë kritike. Nga biseda jonë siç po shifë Gjenerali e kuptoi shumë mirë edhe pozitën tonë që nuk po mundnim për të ndihmuar më tepër, edhe pse ne e kishim bërë punën tonë duke ua dhënë prioritetet ashtu siç na i kishte dorëzuar Gjeneralit Lama. Por, në realitet tani edhe dikush tjetër na venka në arenën e luftimeve që po verifikojka për sulmet finale të aviacionit të NATO-së pa marrë parasysh se cilat caqe ishin prioritare sipas neve dhe Gjeneralit Lama! Gjatë takimit Gjenerali Lama na njoftoi se më vonë do të shkonte për në Bajram Curr dhe Tropojë për të parë prej së afërmi gjendjen e UÇK-së si edhe në atë të zonës së rajonit kufitarë.

Pas këtij takimi u nisëm për në zyrën tonë, dhe që të gjithë u ndamë mjaftë të mërzitur për mos ekzekutimin e caqeve tona me më prioritet që të shpëtonim jetërat e shumë njerëzve mbrenda Kosovës. Në të mbërrirë në zyrën tonë, Kapiteni Wiggis për menjëherë filloi që t'i shkruaj një

shkresë e-mail në kompjuter Gjeneralit John Hendrix. Pas përfundimit të shkresës më ftoi edhe mua që ta lexoj edhe unë edhe që t'ia japë edhe mendimin tim në lidhje me shkresën e tijë para se t'ia dërgojë. Pas dërgimit të e-mailit disa orë më vonë na lajmëruan nga Shtabi Amerikan në Rinas se Gjenerali Hendrix do të vijë në vizitë te ne në orën 15:00, dhe kishte kërkuar nga ne që të ftojmë edhe Gjeneralin Kudusi Lama për një takim urgjent. Kjo ishte një ditë mjaftë dinamike për ne, me shumë ngjarje dhe për një kohë të shkurtër. Pas pranimit të këtij njoftimi i telefonova Gjeneral Lamës dhe e njoftova se Gjenerali Hendrix don që të vijë special për t'u takuar me ty këtu në Kukës. Por, edhe na pyeti se a donë të takohesh këtu në zyrën tonë apo po deshte ai mundë që të vijë tek ju edhe në Bajram Curr? Gjeneral Lama më tha se me plotë dëshirë do ta pres këtu tek ne në Kukës, dhe me kusht që ta lajmëroj atë disa minuta para se me ardhë Gjenerali Hendrix në lokalin tonë...

Sot për gatim ishte rendi im për përgaditjen e darkës, sepse tani veçëse kishim filluar edhe njëfarë rendi shtëpiak. Shkuam në pazarin e Kukësit për të blerë sendet që më duheshin për gatim si: perime, bukë dhe ca bylmetë tjera. Nuk u vonuam shumë, me të marrë sendet u kthyem menjëherë për në banesë. Me të kthyer unë menjëherë ia fillova përgaditjes së gatimit, sepse nuk kishim aq shumë kohë të lirë para se të na vinin mysafirët, gjeneralët Lama dhe Hendrix. Pas gatimit, aty rreth orës 14:00 filluam drekimin, ushqimi që përgaditja si duket na pëlqeu që të gjithëve. Në orën 14:20 pas dite na lajmëruan nga Shtabi Ushtarak i Rinasit se Gjenerali Hendrix, veçëse ishte nisur dhe ishte në fluturim me helikopter për te ne! Nuk vonoi as pesë minuta kur u ndëgjua zhurma e rotorëve të helikopterit i cili veçëse na u ishte afruar për aterim në oborrin tonë para banesës dhe zyrës që kishim aty. Me të shpejtë ikëm në dhomën e gjumit, aty ku kishim garderobën ushtarake sepse ishim me veshje të lirë, dhe u veshëm në shpejtësi me uniformat ushtarake sepse

ashtu e donte rregulli ushtarak, sepse po na vinin Gjeneralët. Derisa zbriti nga helikopteri Gjenerali Hendrix, në anën tjetër të rrugës e pashë se edhe Gjenerali Lama veçse kishte arritur. Me të arritur ata të dy menjëherë që të dy hynë në zyrën tonë edhe ia filluan bisedimet të cilat zgjatën më se një orë, ku edhe u caktua që menjëherë t'i jipet lista e objektivave primare Shtabit në Rinas. Këtë detyrë e kreu vetë Gjenerali Hendrix, në të njëjtën kohë edhe duke i telefonuar me telefonin e tyre satelitorë Bazës së Aviacionit të NATO-së me urdhër që menjëherë këto objektiva të hyjnë në listë dhe të bombardohen, e cila telefonatë tani që të gjithë atmosferën na e ndryshoi, që të gjithë u ndiem pakësa më të relaksuar, e në veçanti Gjenerali Kudusi Lama, unë dhe Kapiteni Wiggis, sepse shpresat tona na ishin shterrur më herët. Po, që atëherë kur kishte filluar sadopak mosbesimi për caqet që ia kishim dhënë Gjeneralit. Tani disi u rigjeneruam edhe na u shtua oreksi për t'u angazhuar edhe më tepër në kryerjen e detyrave tona që na ishin besuar! Pasi e kryem bisedën me Gjeneralin Hendrix, ai me truporjen e tij si xhen-tilmen na përshëndetën edhe u larguan në drejtim të helikopterit i cili kishte dhezë motorët edhe ishte i gatshëm për fluturim, të cilët u ngritën lartë dhe u zhdukën andej prej nga erdhën.

U kthyem që të përshëndetemi edhe me Gjeneralin Lama, me të cilin u përqafuam fort për takimin e suksesëshëm që patëm sot, për çka edhe na u faleminderua përzemësisht për ankesën që i bëmë unë me Kapitenin Wiggis Gjeneralit Amerikan Joe Hendrix për mosmarrëveshjen që na kishte lindë. Ashtu, më i gëzuar se kurrë më parë Gjenerali Lama u nis për menjëherë drejtë rrugëtimit të tij për në Bajram Curr, për të vazhduar vizitën e tij të planifikuar. Tani përsëri na u kthyem shpresat të cilat na ishin shterrur për një kohë. Gjatë ndarjes gjenerali Lama na tha; "Edhe pse nuk do të jemë në zyrën time në Kukës për disa ditë në vijim, prapë se prapë do të jemi në kontakt të përherëshëm me ju për çfarëdo qoftë".

Gjatë mbremjes përsëri ndëgjua krismat e bombardimeve të aviacionit të NATO-së, por edhe kësaj here nuk ishin aspak më të pakëta se herave tjera për shkak të pranimit për nënshkrimin e marrëveshjes së paqes nga vetë Presidenti Serb Millosheviqi. Por, tani ishte bërë një ndryshim edhe ishte vendosë që mos të përdoren bombarduesit e mëdhenj si B-1 dhe B-52, dhe mos të qëllohej mrenda venbanimeve sipas udhëzimeve të NATO-së. Sa për vendbanimet tani ia bënim lehtë gjatë raportimit, i raportohej se i tërë vendbanimi ishte i djegur dhe shkatërruar nga sulmet e forcave serbe, e që në fakt edhe shumë herë ashtu edhe kishte ndodhë. Po, sepse forcat kriminale zakonisht vendbanimet shqiptare në fillim i vritnin apo dëbonin njerëzit, pastaj vidhej dhe plaçkëtejt dhe më në fund ia futnin flakën dhe djegnin në mënyrën më barbare gjithëçka që kishte

mbetur aty!

Në orën 24:00 të mesnatës, përsëri morëm listën me objektivat e reja të cilat na i solli kurriri personal i Gjeneralit Lama. Me të marrë listën me objektivat e reja menjëherë iu përvësua punës së rregulltë me përkthimin dhe verifikimin e koordinatave të objektivave si dhe kapiteni Wiggis me kolegët tjerë ia transmetoi Shtabit të Armatës Amerikane në Rinas.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë 24 orëve aviacioni i NATO-së ndërmori më shumë se 610 sulme mbi forcat serbe, e që deri më sot kishte arritë mbi 31,000 sosh, duke i shkatërruar armikut mëse 10,000 ushtar të vrarë dhe të plagosur. Sekretari i Mbrojtjes së Ushtrisë Amerikane Cohen kishte lajmëruar që sulmet të pakësohen për t'i dhënë kohë nënshkrimit të marrëveshjes me presidentin e Serbisë Slllobodan Millosheviqin, për derisa NATO-ja të verifikojë tërheqjen e plotë të forcave jugosllave nga Kosova, për çka edhe tani veçse sa kishin filluar edhe bisedimet e paqes.

Edhe udhëheqësi i UÇK-së Hashim Thaçi kishte thënë se do ta pranjojë paqen ushtarako politike nga marrëveshja, dhe se pjesëtarët e UÇK-së nuk do të sulmojnë askënd gjatë tërheqjes së trupave të armikut serb.

Presidenti rus Yeltsin i kishte telefonuar Kancelarit Gjerman dhe i kishte kërkuar që NATO -së të ndërprerë sulmet e bombardimeve sepse Beogradi kishte pranuar kushtet e paqes. Premieri Kinez Zhu Rongji i kishte thënë në telefon Kancelarit Schroeder që sulmet ajrore duhet të marrin fund para se të sillt marrëveshja para OKB-së. Kanacelari Schroeder kishte çfaqë optimizëm se asnjëra: as Moskva e as Pekini nuk do ta bllokojnë rezolutën që do të silllej para OKB-së të nënshkruar nga pala e Beogradit e cila e kishte pranuar atë marrëveshje.

NATO-ja tanimë kishte 16.000 trupa në Maqedoni edhe 8.000 në Shqipëri të cilët ishin të gatshëm në çdo moment për t'u futur në Kosovë.

Britania gjithëashtu kishte lajmëruar se veçse 4.000 trupat e tyre ishin të gatshëm që mbrenda 24 orëve të nisen për në trupën paqëruajtëse. U raportua se forcat e NATO-së mundë që të lëvizin për në Kosovë mbrenda 7 ditëve të ardhëshme.

Sipas UNHCR numri i refugjatëve në teren kishte arritur në 782.100, duke patur në Shqipëri 443.300 refugjatë, në Maqedoni 247.800 refugjatë, në Mal të Zi 69.300 refugjatë dhe në Bosne dhe Hercegovinë 21.700 refugjatë. SHBA sipas të gjitha gjasave nga Marsi i 1998 e deri më tani kishin ndihmuar Kosovën me \$210,689,321.

E shtunë, 05 qershor 1999

Ditën e sotme e filluam me më pakë aktivitetet, për shkak se Gjenerali Kudusi Lama nuk ishte në zyrën e tij. Ai kishte shkuar në rrethin e Bajram Currit për të vizituar prej se afërmi luftëtarët e UÇK's si dhe pjesëtarët e Ushtrisë së Shqipërisë që ishin në zonën kufitare diku për rreth kufirit Shqipëri-Kosovë.

Gjatë ditës së sotme mora një telefonatë nga Shtabi Ushtarak i Shqipërisë në Kukës, në telefonatë ishte Selim Spahiu, Shefi i Shtabit të Kukësit i cili na ftoi që të takohemi me të dikur më vonë. Pakë më vonë shkuam unë dhe kapiteni në kazermën ushtarakë të Kukësit, aty ku takuam Shyqyri Shabanin i cili ishte Shefi i Zbulimit. Takimi ishte thirrur më së shumti për incidentin të cilin e kishte shkatërruar ushtria serbe, duke sulmuar me topa vendbanimet kufitare për mbrenda Shqipërisë, prej të cilave sulme kishte gjetë vdekjen edhe një vajzë 17 vjeçare si dhe ishin plagosur 3 fshatarë të tjerë. Pasi se na spjeguan për ngjarjen, gjithëashtu na treguan edhe për kahjen se prej nga po vinin

predhat e artilerisë serbe në bazë të cilave i kishin nxjerrë edhe koordinatat e sulmit, dhe vendosëm që edhe ky të jetë objektivi më primarë. Me të kthyer në zyrën tonë edhe këtë listë objektivash e verifikuam, dhe menjëherë ia transmetuam Shtabit të Rinasit për akcionin e ardhshëm të aviacionit të NATO-së. Në këtë sulm kishim në rend të parë që të vihen përsëri objektivat e caqeve të mëparëshme, nga Verbica e deri në Zhur.

Gjatë ditës së sotme në mënyrë intensive po zhvillohej edhe takimi i marrëveshjes në Aeroportin e Haxhi Tepes në Kumanovë, në mes të Gjeneralëve të NATO-së dhe atyre të forcave jugosllave. Në këtë takim në "Marrëveshjen e Kumanovës" pala serbe kishte arritë 3 orë me vonesë, në vendin ku duhej të nënshkruhet "KAPITULIMI" (Dorëzimi) i luftës së tyre në Kosovë, si dhe planet dhe mënyra e tërheqjes së të gjitha trupave të armikut nga territori i Kosovës, si dhe zavendësimi i tyre me trupat paqëruajtëse të NATO-së dhe disa vendeve të tjera mike.

Me një fjalë ishte nënshkrimi i KAPITULIMIT dhe dështimit serb në Ballkan!

Përsëri edhe sot vazhduan bombardimet e aviacionit të NATO-së mbi pozicionet serbe, por me intenzitet shumë më të ulët se ditëve të më parme.

Gjatë ditës së sotme kemi edhe ndërrimin e parë që nga fillimi të pjesëtarëve tanë në Njësinë e Forcave Speciale Amerikane. U largua Timi, një ushtarak mjaftë profesional dhe i përsosur dhe u zavendësua me një ushtarak me ngjyrë i quajtur Kevin. Ndërrimi i pjesëtarëve ushtarak sipas marrëveshjes ishte që zakonisht bëhej çdo 6 muaj, mirëpo tani meqenëse jemi në gjendje lufte edhe ndërrimet nuk ishin aq të zakonshme, sepse mvarej nga situata aktuale në teren. Gjatë ditës së sotme meqenëse kishim mjaftë kohë të lirë, gjithëashtu përcollëm edhe ndeshjen futbolistike në mes të Kombëtares së Shqipërisë

me atë të Norvegjisë, ndeshje e cila na nervozoi pakë sepse Shqipëria e humbi lojën me rezultat 1:2!

Pas lojës së futbollit na erdhi edhe posta me rrobet tona të lara që i kishim dërguar për pastrim për më tepër se një javë, dhe disa sende që na duheshin të cilat na i sollën disa ushtarak nga Shtabi Amerikan në Rinas.

Sot u gëzova pa masë sepse më arriti edhe një letër prej familjes sime nga SHBA, ku aty mbrenda letërës kisha edhe një kartë festive e punuar nga bukuroshet e babet Liridona dhe Mimoza. Po edhe Shahadja më kishte dërguar një kartë me rastin e ditëlindjes time që kisha para 10 ditësh! Karta që më së tepërmi më gëzoi ishte një vizatim i bukur me dorë të lirë i bërë për ditëlindjen time nga vajzat e mia, për të cilat isha përmallu bukur shumë!***

Informacionet e 24 orëve të fundit

Nga diplomacia botërore, sot gjithëashtu pati edhe shumë takime të tjera në mes të burrështetasve rus dhe atyre amerikan. Sot u takuan edhe Zëvendës Sekretari i Shtetit Amerikan Talbot me anvojin e BE Ahtisaarin në Helsink, ku u vërtetu se Rusia në ditën e djeshme nuk ishte pajtuar që të dërgojë trupa paqëruajtëse në Kosovë. Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-së Cohen, tha se pamarrë parasysh për pjesëmarrjen e trupave ruse ne do të vazhdojmë me detyrën tonë përpara, me zbarkimin e trupave tanë paqëruajtëse të KFOR-it për në Kosovë. Marrëveshja nuk kishte kurrëfarë bisede për dorëzimin e Presidentit Serb Slllobodan Millosheviqit për akuzat e krimeve në Kosovë në Tribunalin Ndërkombëtarë të Krimeve për ish Jugosllavinë në Hagë, si dhe iu sqarua Serbisë se SHBA nuk e suporton ndihmën në rikonstruimin nga bombardimet e NATO-së në Serbi. Më vonë gjatë ditës së sotme, Rusia filloi të japë shenjë se donte të bëhej pjesë e trupave paqëruajtëse e NATO-së dhe gjithëashtu u bisedua edhe për ndërprerjen e bombardimeve të NATO's për 2-3 ditë pasi se të fillojë tërheqja e trupave serbe.

Presidenti i Francës Chirac tha se Bashkësia Evropjane do të luaj rol in kryesorë deri në formimin e autoriteteve kosovare të tranzicionit, për derisa të formojnë institucionet e qeverisjes. Gjatë kësaj kohe edhe Kancelari Gjerman Schroeder, ishte mjaftë optimist se Kina dhe Rusia nuk do të bllokoni Rezolutën në Kombet e Bashkuara për Kosovën. Sipas fjalëve të Ministrit të Jashtëm Gjerman Fischer, Rezoluta e Kombeve të Bashkuara për Kosovën është e kompletuar për pajtim paqësor nga Ministrat e punëve të jashtme të G 8.

Aviacioni i NATO-së gjatë ditës së sotme kreu 72 operacione kundër forcave serbe.

Në Kosovë qëlluan: 21 topa artilerike, 30 mortaja, 4 tanke, 10 autoblanda, 8 artileri anti ajrore si dhe automjetet e tjera ushtarake. Gjithëashtu u sulmuam edhe: depot e municionit në Novi Pazar, Boljevac dhe Kurshumli si dhe depoja e karburantit në Somobor, treni me cisternë karburanti në Leskovc, shtabi i MUP'it në Kula



29 Maj 1999 Kukës/Shqipëri, me Njësinë e Forcave Speciale të Amerikës, në rreshtin e fundit Gjenerali Arbëresho-Amerikan John W. Hendrix dhe Gjenerali Kudusi Lama Komandant në Divizionin e Kukësit

Milicia, aeroporti në Ponikve, rajoni iushtrimave në Çuprija, rrethi i radios në Rudnik, radio stacionet në Serbobran, Pirot dhe Kapaonik.

E diel, 06 qershor 1999

Tani për ne në Kukës gjithëçka po fillonte shumë me tempo të ngadalët, e bile për ne menjëherë edhe filloi gjithëçka të bëhet disi monotone, për shkak se ishim mësuar në një takt shumë më të shpejtë dhe me dinamikë me shumë lëvizje.

Sot po mbanë një ditë e nxehtë dhe e bukur. Nuk kishte asgjë interesante deri në këtë moment. Bisedimet e Kumanovës që po zhvilloheshin në mes të krerëve ushtarak të NATO's dhe Gjeneralëve kriminel serb, siç po shihej nuk kishin ritëm të duhur. Aty kishin një letër marrëveshjeje prej 6 faqesh, ku i urdhërohej që pala serbe ta nënshkruaj! Marrëveshje për të cilën lirisht mundë të them se ishte nënshkrimi i kapitullimit të tyre, si dhe nënshkrimi i garantuar që mbrenda një kohe të caktuar që të gjithë forcat serbe duheshin që të largoheshin njëherë e përgjithmonë nga territori i Kosovës.

Koha e largimit të tyre nga Kosova ishte caktuar në një afat prej një jave, si dhe:

-Të qëndrojnë largë kufirit kosovar në distancë mëse 25 km.

-Tërheqja e trupave serbe të bëhet vetëmse rrugëve që iu ishin caktuar nga NATO-ja.

Në orën 10:30 para dite, më telefoni Gjenerali Kudusi Lama i cili ende po ndodhej në Bajram Curr. Nga biseda dukej se ishte mjaftë i mllufosur për sulmin serb pëmbrenda kufirit të Shqipërisë si dhe sulmin serb mbi Forcat e UÇK-së.

Gjenerali Lama më herët, para 3 ditësh kishte kërkuar që të bombardoheshin pozicionet serbe në koordinatat që na i kishte dhënë caqet për në Shaptej, Isniq, Pozhar dhe Lum Bardh, për arsye se këto koordinata nuk ishin prekë aspak nga bombardimet e avacionit të NATO's. Nga mllëfi mu shpreh: "Se poqëse nuk vepron Aviacioni i NATO-së në këto pozicione që ua kam dhënë unë, nuk dua të kem kurrëfarë pune me to. Dua të them se unë nuk do të merrem më me dhënien e objektivave të mëtejme!" Fjalët e Gjeneralit Lama ia thash Kapitenit Walter Wiggis, bile duke ia dramatizuar edhe më tepër, i cili

për një kohë të shkurtër mbeti disi i habitur, dhe menjëherë i mori në lidhje Shtabin Amerikan në Rinas, dhe kërkoi që të lidhet me zyrën e Gjeneralit Hendrix të cilit ia çfaqti pakënaqësinë e kolegut të tijë Gjeneralit shqiptar Kudusi Lama. Nga kjo ankesë menjëherë nga zyra e Gjeneralit Hendrix ishte dhënë urdhëri që të gjitha ato pozicione serbe që ishin kërkuar nga Gjenerali Lama të sulmohen menjëherë nga bom- barduesit e NATO-së. Këto ishin caqe objektivash për të cilat po insistonte me të madhe Gjenerali Lama. Tani ky sulm ishte i kërkuar edhe nga Gjenerali Amerikan, ku Aviacioni i NATO-së mbrenda një kohe të shkurtër kishte arritë që t'i bombardojë dhe për fat të mirë derisa po kryhej ekzekutimi i këtyre objektivave, atje afër kishte qëllu edhe vetë Gjenerali Lama që e kishte vështruar edhe vetë ai nga një pikë shumë të afërt. E për këtë, tani ishte tepër i kënaqur me akcionin, dhe menjëherë na tregoi se ky sulm i avacionit të NATO-së kishte shkatërruar totalisht dy batalionet e forcave të armikut serb!

Për hezitimin e nënshkrimit të marrëveshjes së NATO-së nga forcat serbe, tani sa na erdhi lajmi se bombardimet duhet të vazhdojnë edhe më tej, por edhe në një intenzitet edhe shumë më të madh se gjerë më tani, për t'ia bërë me dije Serbisë se ata nuk kanë kurrëfarë rrugëdalje përpos nënshkrimit të kapitullimit të tyre definitiv!

Pas mosnënshkrimit të marrëveshjes së Kumanovës, u vendos që tani përsëri bombardimet të vazhdojnë edhe me bombarduesit më të mëdhenjë që kishin në dispozicion aleanca e NATO-së, siç ishin bombarduesit B-1 dhe B-52, të cilët për një kohë u vendos që t'i largojnë nga arena e luftimeve sepse pala serbe ishte dakorduar se po nënshkruante marrëveshjen. E tani, Millosheviqi po lozte taktikën e tij të rrenave që e dinë më së miri duke i ikë nënshkrimit të marrëveshjes siç kishte vepruar qysh nga prishja e Jugosllavisë!

Tani pa kurrëfarë vonese aeroplanët luftarak bombarduesit e avacionit të NATO-së filluan të na çfaqen edhe mbi qiellin e hapur të Kukësit, prej nga po orkestrohej sulmi mbi forcat paramilitare ushtarake policore serbe në mbrendësi të Kosovës.

Rreth orës 16:00 mbi qiellin e



23 Nëntor 1999, Sojevë /Kosovë, Shahadija në mesin e ushtarakëve amerikan me Presidentin e SHBA's Bill Clinton

Kukësit pamë se u paraqitën 4 bombardues B-52 të cilët kaluan kufirin dhe u futën mbrenda Kosovës, dhe si duket kishin zbrazë bombat e tyre në një largësi jo aq të madhe prej nesh, diku në mes të Koshares dhe Prizrenit prej nga ende po ndëgjoheshin gjuajtje nga artileria serbe mbi pozicionet e UÇK'së, edhe në mbrendësi të Shqipërisë.

E gjithë njësia jonë që ishim në Kukës u kënaqëm kur pamë bombarduesit B-52 duke fluturuar në drejtim të pozicioneve serbe, pasi se e dinim shumë mirë konsekuencën e këtyre bombarduesëve. Një bombardues i tillë zakonisht kishte 50 predha, dhe secila predhë kishte peshë mbi 225 kg. eksploziv, të cilët patëm rastin që t'i shofim edhe në sulmet e më herëshme rreth po të njejtës hapësirë.

Pas bombardimit të B-52, thajse për menjëherë pushuan të gjitha krismat e artilerisë serbe nga kjo hapësirë, e që po ndëgjoheshin më herët! Tani me kthyerjen e sulmeve të NATO-së në nivelin e mëparmë ishte diçka pozitive edhe për neve, sepse të gjitha akcionet do të zhvillohen mbrenda hapësirës së Kosovës, dhe në të cilat njëjti ynë në bashkëpunim me njësinë vëzhguese të UÇK-së dhe Gjeneralit Kudusi Lama i kishim në kontrollë të plotë! Nga këto

bombardime të rrepta mendoj se sot do të kishte një bilanc rekord të viktimitave të gjakatarëve serb, si dhe shkatërrim total të arsenalit të tyre.

Nga këto akcione gjithëashtu mendoj se edhe forcave të UÇK-së do t'i lehtësohet puna e tyre, dhe do ta e kenë shumë më lehtë rikthimin e tokave të pushtuara nga armiku, armiku shekullorë serb.

Bombardimet e ditës së sotme të avacionit të NATO-së vazhduan deri në orët e vona të natës, e nga të cilët kohë pas kohe ndëgjoheshin detonime shumë të fuqishme.

Gjatë ditës së sotme gjithëashtu dolëm në teren, shkuam deri në afërsi të kufirit të Kosovës, në afërsi të Morinës, ku ishim afër pikës kufitare. Ishim në një pikë prej nga mundë të shifeshin forcat e armikut. Shkuam për të përcjellur prej së afërmi gjendjen se ç'po ndodhte. Në atë pikë qëndruam deri në orën 23:00 të mbrëmjes, dhe gjatë kësaj kohe pamë vetëm se dy ushtarë serb në pozicionet e tyre, në dallim nga herat tjera ku shifeshin numër i madh i tyre dhe me armatim të ndryshëm për rreth.

Nga këto pamje po shihej se bombarduesit e NATO-së e kishin kryer punën e tyre ashtu siç duhej. Siç po mundë të vërehet tani, ata kishin shkatërruar gati në tërësi të gjithë ato forca të mëdha serbe që ishin në këto anë, në afërsi të kufirit me Shqipërinë.

Pas kthimit në vendqëndrimin tonë më vonë gjatë mbrëmjes, nga lajmet e BBC -së për akcionin e bombarduesve të avacionit të NATO-së, e ndëgjuam edhe në mbledhjen për media nga zëdhënësi i NATO-së në Bruksel z. Jemie Shea, nga pyetja e gazetarëve që iu bë: "A po ndërmerret ndonjë veprim në lidhje me tërheqjen e forcave serbe nga Kosova, sepse tani gjatë tërheqjes së tyre sigurisht se trupat serbe do të sulmohen edhe nga Forcat e UÇK-së, si kundërpërgjigje për krimet e bëra nga forcat serbe?". Përgjigjeja e tij ishte alegorike: " Sa për trupat

serbe, siç na kanë thënë herë pas here liderët e tyre, se ata i kishin shkatërruar forcat e UÇK-së në tërësi, pra nuk kanë se pse të frigohen prej tyre, sepse sipas fjalëve të tyre ato forca (UÇK-ja) as që ekzistojnë më. Dhe në të njejtën kohë forcat serbe nuk duhet të mërzhiten për shkak se askush nuk do t'i kërkojë atyre \$1000 për ta kaluar kufirin siç po vepronin ata me refugjatët shqiptarë. Forcat serbe mundë të ikin nga Kosova pa kurrëfarë pengese!"

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë 24 orëve të fundit patëm 483 fluturime të avacionit të NATO-së, në këto sulme u shkatërruan: 20 armë artilerike, 17 autobllinda, 4 tanke, 4 mortaja dhe 15 automjete të tjera ushtarake, si dhe u sulmuan objektet ndihmëse për forcat serbe për pastrimin etnik në Kosovë: depoja e municionit në Kurshumljije, posti komandues në Prishtinë, radio rrethi në Rudnik dhe posti i mbrojtjes ajrore në Kapaonik.

Tani çdo gjë kishte marrë kahje krejtësisht tjetër, me okupimin e Kosovës Serbia ishte në kolaps total, e që tani pritej edhe ndarja e Malit të Zi, dhe ndoshta edhe ndarja e Sanxhakut dhe Vojvodinës të cilët nuk ishin aspak të kënaqur me politikën e shkatërruesit të Jugosllavisë nga vetë Presidenti Slobodan Millosheviq!

Sipas organizatës së UNHCR'së numri i refugjatëve Kosovar në Shqipëri kishte arritur në 443,800, në Maqedoni në 247,400, në Mal të Zi në 69,400, në Bosne-Hercegovinë 21,700 që tani kishte arritur numri me mbi 782,300 refugjatë.

E hënë, 07 qershor 1999

Pas shkuarjes së Gjeneralit Kudusi Lama në Tropojë dhe Bajram Curr, puna jonë ishte ngadalësuar bukur shumë, sepse Gjenerali ishte burimi ynë kryesorë i informatave për procesin e punës tonë të lëvizjeve në teren si të UÇK-së në



1 Qershor 1999 Kukës/Shqipëri, Unë me Njësinë Speciale të Armatës Amerikane me Gjeneralin Arbëresho-Amerikanin John W. Hendrix

njëren anë, dhe poashtu edhe të trupave të armikut jugosllav në anën tjetër. Mu për këtë arsye mendoja se edhe puna jonë gjatë këtyre 3 ditëve do të jetë e reduktuar në përmasa të dukshme me shkuarjen e Gjeneralit Lama. Tani po detyrohem të marrim pushime edhe pse asnjëri prej nesh (njësisë tonë) nuk e dëshironim këtë lloj ndërprerje! Për të qenë sado pakë të nuanun nganjëherë disa nga njësitë jonë kemi filluar të dalim në vëzhgim të gjendjes për rreth kufirit deri në afërsi të pikës kufitare në Morinë. Po, sa për të parë prej më së afërmi gjendjen për rreth kufirit si dhe për të parë ndonjë lëvizje përtej kufiri, në pozicionet e armikut serb. Ne ende po merrim listën e objektivave të reja nga Shtabi i Ushtrisë së Shqipërisë në Kukës, mirëpo në një intenzitet shumë më të ngadalshëm dhe më të vogël. Sot takuam Shyqeri Shabanin Shefin e Zbulimit të Ushtrisë së Shqipërisë nga Divizioni i Kukësit, të cilin kësaj radhe e ftuam që të vijë në zyrën tonë për të biseduar në lidhje me disa objektiva prej nga po gjuanin me artileri forcat paramilitare ushtarake serbe, prej nga Verbnica dhe rrethi i Zhurit. Por ata gjuanin edhe nga pjesët tjera për rreth kufirit të Shqipërisë me Kosovën. E ftuam me qëllim që në sulmet e ardhshme të qëllohen dhe neutralizohen edhe ato pikat e armikut serb.

Në orën 15:30 pas dite, filluan bombardimet nga aviacioni i NATO-së me dy bombardues B-52, duke filluar me sulmet e tyre menjëherë përtej kufirit, në Gorzhup, Tejec, Malaj, Planeje dhe bjeshkët e malit Pashtrik. Lajmet nga tereni po na tregonin se këto bombardime dhe ato të ditëve të fundit ishin shumë të suksesëshme. Vetë fakti nga tereni po na tregon se gjatë këtyre ditëve edhe kristmat e artilerisë së armikut serb kishin pushuar, nuk ndëgjoheshin granatimet më siç po ndëgjoheshin ditëve të kaluara. Në orën 22:30 të mbrëmjes më mori në telefon Selim Spahi Shefi i Gjeneral Shtabit në Kukës për të më lajmëruar dhe për të na njoftuar me njohuritë më të reja nga tereni që i paskan arritur nga Forcat Vëzhguese të Ushtrisë së Shqipërisë prej diku në afërsi të kufirit Shqipëri-Kosovë, diku krejt në afërsi të Morinës nga tereni i luftës së forcave çlirimtare të UÇK-së, të cilët duke i faleminderuar edhe aviacionit e forcave aleate të NATO-së gati se kishin arritë të marrin nën kontroll të gjitha fshatrat për rreth kufirit si: fshatrat Gorzhup, Tajec, Majaj dhe Planeje. Me këtë na lanë të kuptojmë se bombardimet e më herëshme me B-52 nga Aviacioni Amerikan ishin shumë efikas dhe të suksesëshëm! Por edhe nga ana tjetër Forcat e UÇK's të ushtruara dhe përgaditura si më mirë ishin në gjendje të rimarrin këto pozicione nga armiku kriminel serb.

Përgaditja dhe trimëria e forcave të UÇK-së u pa edhe nga lufta e tyre në ditën e djeshme në afërsi të Planesë, kur njësitë e UÇK-së po gjuanin nga mbrendësia e pyellit me mortaja të kalibreve të ndryshme në afërsi të fshatit të Planesë, të cilat gjuajtje u vlerësuan shumë nga kolegët e

mijë të Forcave Speciale Amerikane, të cilët janë elita ushtarake e Armatës Amerikane dhe shumë më profesional. Kolegët e mijë Amerikan vërejtën prej së largu, dhe më thanë se gjuajtjet e tyre ishin shumë precize dhe të koordinuara në mënyrën më efikase që ishte e mundur. Këto ushtarë para disa ditësh vërejtën edhe gjuajtjet me artileri të forcave serbe drejt pozicioneve të UÇK-së, gjuajtje të cilat nuk ishin shumë të sakta. E sidomos në rastin e më hershëm kur forcat e armikut serb po mundoheshin që ta qëllonin repetitorin e RadioTelevizionit të Kukësit, i cili ishte përforcues që programet e tyre të shifeshin edhe në mbrendësi të teritorit të Kosovës, e që gjuajtja e tyre ishte shumë largë caktat që i bëri të qeshen këta ushtarë, sepse gjuajtjet e tyre nuk ishin aspak precize. Epërsia dhe fati i forcave serbe ishte sepse ata kishin armatim të rëndë dhe të shumëllojshëm, e që për UÇK-në ishte e vështirë që t'i përballonin me armët e tyre që kryesisht ishin të këmbësorisë së lehtë si: kallashnikov, mortaja dhe disa armëve tjera të lehta, mirëpo këta të rinjë kishin trimërinë, guximin dhe zemrën me plotë dëshirë për çlirimin e vendit të tyre, që armiku nuk kishte për ta përballuar asnjëherë!

Gjatë ditës së sotme bombarduesit e aviacionit të NATO-së kishin bërë më shumë se 700 fluturime, e ku shumica e sulmeve të tyre ishte përqendruar për mbrenda kufinjëve të Kosovës. Sipas njoftimeve nga Shtabi Amerikan në Rinas, planet për bombardime në ditën e nesërme ishte që të shtoheshin sa më tepër që është e mundur, dhe me plan që tani të shfrytëzoheshin për sulmet mbi forcat e armikut serb edhe bombat më të mëdha që ishin përdorur gjërë më tani! Këto bomba peshonin edhe mbi 1000 kg, me qëllim të shkatërrimit të bunkerëve dhe tuneleve nën tokë ku ishin të përqendruar trupat e armikut si dhe municioni i tyre. Për këto sulme presim t'i shofim dhe ndëgjojmë në ditën e nesërme, nesër në ditën e Martë më 08 qershor 1999, sulme që do të demtojnë armikun materialisht dhe shpirtërisht në themel. Që donë të thotë se ata do të kenë shkatërrim të plotë. Sipas fjalëve të kolegëve të mijë Amerikan që më thonin se, edhe nëse arrinë të shpëtojnë ndonjëri prej ushtarëve të tyre, ata do të jenë të shkatërruar edhe mentalisht. Po, sepse ato lloj bombash janë të pa përballueshme për çdo njeri të gjallë sa do që të jenë të fortifikuar.

Situata informative e datës 07-06-1999

(Lista origjinale e objektivave të armikut serb nga UÇK-ja pa koordinata AE)

1. Situata e luftës

Në mes të datave 05 deri 07-06-1999 forcat serbe po sulmojnë ashpër mbi forcat tona. Gjatë tre ditëve të fundit forcat tona ishin shumë aktive në regionin e Dukagjinit dhe Pashtrikut, ku i mbrojtëm me shumë sukses pozicionet tona.



10 Maj 2000 Sojevë /Kosovë, tani në punë së bashku me Shahadijen në Njësinë e Jurispodencës së Armatës Amerikane "JAG" në kampin "Bondsteel".

2. Informatat për armikun

Forcat serbe ishin mjaftë aktive në regjionin e Dukagjinit, atje ku ishim sulmuar nga këmbësoria e tyre e motorizuar dhe e mekanizuar, nga policia speciale dhe forcat paramilitare, artileria dhe tanket. Forcat serbe janë përqendruar në drejtim të Pashtrikut në:

- Qafa e Merturit
- Në lartësinë pa emër e 1300 dhe 1400 m. në lindje të Malit Kurora
- Qafa e Likës
- 500 m. në jug të Malit Podi
- Binaj
- Rreth Lumit të Drinit

Gjatë këtij sulmi armiku po përdorë armë kimike LHL, artileri edhe aviacionin përmbrenda teritorit të Kosovës, dhe në të njëjtën kohë janë duke u përfortuar në pozicionet e tyre me mjete të motorizuara dhe autobllinda.

Rreth Plafit të Kurorës gjinden përfortimet e 10 autobllindave dhe tankeve

Në zonën e luftës të Lumbardhit dhe Kotradiq të Brigadës 131 armiku është duke gjuajtur me mortaja, artileri dhe tanke, ku patën pakë sukses, mirëpo më 06-06-1999 nga bombardimet e aviacionit të NATO's dhe sulmeve tona, armiku kishte humbur një batalion të këmbësorisë si dhe maqinerinë ushtarake. Sot më 07-06-1999 forcat e reja serbe po vijnë për të luftuar në drejtim të Brigades 131 dhe Pashtrikut.

3. Raporti i forcave tona

Forcat tona patën sukses në regjionin e Dukagjinit dhe Pashtrikut, patëm sukses në mbrojtjen e pozitave tona pa marrë parasysh numrin e ushtarëve dhe teknikës (së armikut). Forcat e armikut patën humbje të mëdha në drejtim të Lumbardhit dhe

Kostriqit ku humbën gati se një batalion të këmbësorisë si dhe teknikë ushtarake. Nga sulmet artilerike të armikut ne patëm 5 ushtarë të lënduar.

Në këtë situatë forcat operative në rajonin e Dukagjinit ku gjindet Brigada 138 me ndihmën e bombardimeve të NATO-së kanë sukses në lëvizjen e tyre.

4. Popullata civile

Në Kçiq të Madh janë 25.000 njerëz të pa mbrojtur

Në Serbicë (Skenderaj) janë 10.000 njerëz të pa mbrojtur Aviacioni i NATO-së bombardoi me sukses 1 Batatalion (me mbi 300 pjesëtarë) ushtarë dhe teknikë."

1999

"Situata informative e orës 22:40
datës 07-06-

Në Pashtrik armikut i erdhën në përfortim forcat e mëdha të këmbësorisë së motorizuar. Grupi ynë vëzhgues mendon se po bëhen gati që në mëngjes të na sulmojnë. Këto janë objektivat që NATO-ja duhet t'i ndërmarrë urgjentisht.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme patëm mëse 800 sulme të bombarduesve të aviacionit të NATO-së mbi forcat jugosllave, dhe përqendrimi i tyre ishte në përgjithësi për rreth kufirit Shqipëri-Kosovë, ku po shifej se armiku serb të ketë patur humbje kolosale të mëdha në ushtarë dhe material luftarak. Gjatë ditës së sotme u bë bombardimi i ndërtesës së RTV-së të Serbisë në Beograd si edhe Ambasada Kineze Beograd në të cilën u vranë edhe 3 gazetarë Kinez.

Takimi i Oficerëve të NATO-së dhe atyre jugo- sllave që po mbahej në afërsi të kufirit me Maqedoninë në fshatin Bllacë, ku nuk po merrim

pjesë oficerët rus në shenjë proteste për shkak se bombardimet e NATO-së ende nuk ishin ndalë por ato po vazhdonin. Në këtë mbledhje palët e NATO-së me ato jugosllave kishin dështuar për kohën se kur dhe si të tërhiqeshin trupat jugosllave nga Kosova. Problemi ishte se oficerët jugosllav po kërkonin një afat 14 ditësh për tërheqje, e jo siç i kishin urdhëru oficerët e NATO-së si dhe largimi i tyre të bëhej për të njëjtës rrugë siç kishin hyrë mbrenda në Kosovë!

Gjenerali Britanez Lt. Gjeneral Michael Jackson pas 12 orësh bisedë, tha se trupat jugosllave nuk dojnë të garantojnë kthimin e sigurtë të refugjatëve kosovarë, si dhe tërheqjen e të gjithë forcave të tyre të sigurisë nga Kosova. Në këtë marrëvshje kërkohet që edhe forcat e armikut serb duhen të largoheshin nga kufiri në distancë prej 15 milash largë kufirit me Kosovën, si dhe të jenë 5 zona ushtarake të KFOR-it në Kosovë e që të kontrolloheshin nga ushtria: Amerikane, Gjermane, Italiane, Franceze edhe Britaneze, e që secila të ketë kontrollin në zonën e tyre. Sot u bë publike se Presidenti serb Sllobodan Millosheviq i kishte transferu 5 milion Marka në një bankë të Afrikës së Jugut, dhe se kishte kërku që të

ji pen viza për të gjithë familjen e tij. Sipas planit të paqes gjithashtu u kërkua nga Gjenerali Shelton Shefi i Gjeneral Shtabit Amerikan që edhe Forcat e UÇK-së të lënë anash armët e rënda të tyre, mirëpo atyre u lejohet dhe mundet të mbajnë vetëmse armët e lehta të zjarrit.

Sekretari i Mbrojtjes së SHB -së, William Cohen tha se: edhe pse do të jenë trupat ruse në Kosovë, edhe ata do të jenë nën komandën e NATO-së dhe se nuk do të ketë sektor në vete për trupat ruse.



Veton Zymberi, redaktor i sportit

Superliga rikthehet me derbin Ballkani - Gjilani

PRISHTINË, 31 MARS - Pas ndeshjeve të përfaqësueses, këtë fundjavë rikthehet Superliga e Kosovës në futboll me xhiron e 27. Derbi i javës zhvillohet të shtunën në mes të Ballkanit dhe Gjilanit. Suharekasit po kalojnë nëpër një formë shumë të dobët në xhirot e fundit, kurse në pesë sfidat e fundit kanë katër barazime e një humbje. Edhe përkundër formës së dobët, kampionët janë vetëm një

pikë larg vendit të parë. Kundërshtari i tij, Gjilani, me formë qëndron pak më mirë, ka dy fitore, dy barazime e një humbje. Gjilanasit janë në pozitën e tretë me 40 pikë. Të shtunën zhvillohen edhe dy përballje të tjera. Është sfida mes Prishtinës dhe Trepçës '89. Të dyja ekipet kanë formë përafërsisht të njëjtë në pesë ndeshjet e fundit. Sikurse kryeqytetasit, po ashtu edhe mitrovicasit

morën pikët e plota javën e fundit. Sa i përket renditjes, bardhekaltrit janë shumë më mirë, e shohin veten të katërtit me 35 pikë, teksa minatorët të tetit me 29 sosh. Sfida e fundit e së shtunës është mes Llapit e Malishevës. Vetëm një fitore për llapjanët në pesë ndeshjet e fundit, ecuri negative e cila ia rrezikon edhe vendin e pestë. Katër pikë janë më lartë se kundërshtari, kurse Malisheva është e shtata. Të dielën janë

dy ndeshje.

Liderja e Superligës, Drita, e pret Drenicën. Dy fitore, dy barazime e një humbje është bilanci i të kaltërve nga Gjilani, teksa ekipi nga Skenderaj ka formën më të dobët nga të gjitha ekipet, një fitore e katër humbje, tri prej tyre rresht. Klubi me formën më të mirë në pranverë është Ferizaj, që këtë të diel i shkon Dukagjinit. Në javën e fundit klinasit pësuan, derisa ferizajasit



barazuan. Sa i përket renditjes, Dukagjini është i gjashti, kurse Ferizaj i parafundit.

Kelmendi: Gratë në Kosovë janë më punëtore, kur kanë një qëllim asgjë nuk mund t'i ndalojë



Prishtinë, 31 mars - Trajnerja dhe kampionia olimpike, Majlinda Kelmendi, ka thënë se gratë në Kosovë janë më punëtore pasi, sipas saj, kur kanë një qëllim askush nuk mund t'i ndalojë. Kështu deklaroi Kelmendi në një intervistë dhënë Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. 31-vjeçarja tani është duke i trajnuar kampionet olimpike Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova. "Nuk është aq e vështirë sepse edhe kur kam qenë sportist gjithmonë jam

munduar t'i ndihmoj", ka shpjeguar Kelmendi, e cila ka shtuar se ende ka raste kur gjatë një lufte po emocionohet që të hidhet në tatami. "(Kur jam në karrigen e trajnerit) bërtas shumë, ngrihem dhe harroj që nuk mund të flas gjatë luftës. Por ndonjëherë emocionohem aq shumë sa dua të hidhem në tatami!". Kelmendi, gjithashtu, beson se Kosova mund të shkruajë edhe më shumë histori në këtë sport. "Përderisa e kemi Tonin kryetar, besoj vërtet se Kosova do të ketë

një skuadër të suksesshme të xhudos", ka shtuar Kelmendi. "Ajo është vërtet e fortë, por nuk kishte aq shumë përvojë, veçanërisht për garat e mëdha të seniorëve", shtoi Kelmendi për 22-vjeçaren që së fundi ka ngjitur dy podiume të Grand Slam të IJF-së. "Kështu që tani kemi disa emra të rinj të mirë edhe për djemtë dhe vërtet besoj se xhudoja e Kosovës nuk do të përfundojë apo ndalet me gjeneratën që e kemi tani sepse po punojmë edhe për brezin e ri".

Sot e nesër zhvillohet xhiroja e fundit e Superligës

PRISHTINË, 31 MARS - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 28-të apo e fundit për garat e rregullta. Sfida e parë zhvillohet në mes të Trepçës dhe Vëllaznimit. Mitrovicasit do të hyjnë në "play-off"-i nga vendi i katërt, ndërsa kuqezinjët nga vendi i gjashtë. "Xehetarët" kanë 16 fitore e 11 humbje, ndërsa skuadra nga Gjakova nëntë fitore e 18 humbje. Rahoveci që ka vetëm katër fitore e 23 humbje do të ndeshet me Pejën në formë të lartë, që ka 20 fitore e shtatë humbje, madje

duke regjistruar shtatë fitore radhazi dhe është favorite ndaj "Vreshtarëve". Bashkimi - Golden Eagle Ylli zhvillohet të dielën në Therandë, me prizrenasit që kanë siguruar pozitën e pestë me 11 fitore e 16 humbje, ndërsa kampionët numërojnë 19 fitore e tetë humbje. Kjo xhiro përmbyllet me sfidën ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Sigal Prishtinës. Prizrenasit do të luajnë në "play-out" me finalistin e Ligës së Parë, kurse prishtinasit në "play-off" do të

hyjnë nga vendi i parë. Prizreni pas 27 ndeshjeve ka 8 fitore e 19 humbje, kurse Prishtina 21 fitore e gjashtë humbje.

SUPERLIGA - Java 28

Të shtunën takohen:
16:30 Trepça - Vëllaznimi
20:00 Rahoveci - Peja

Të dielën takohen:
17:00 Bashkimi - Golden Eagle Ylli
20:00 Ponte Prizreni - Sigal Prishtina



Mervan Bejtullahu debuton me sukses në garat e UEFA-s

Prishtinë, 31 mars - Gjyqtarët kosovarë vazhdojnë me sukses të dëshmojnë edhe në arenën ndërkombëtare. Së fundmi, Mervan Bejtullahu dhe Fatmir Sekiraqa kanë qenë të deleguar nga UEFA në turneun kualifikues për Evropianin 2023 për kombëtarët U17 që u mbajt

në Portugali, prej 21 deri më 29 mars. Mervan Bejtullahu, i cili sivjet është pajisur me stemën e FIFA-s, i ka drejtuar me sukses dy ndeshje të këtij grupi, Portugali - Sllovakia dhe Sllovakia - Poloni, derisa ka qenë gjyqtar i katërt në ndeshjen Portugali - Poloni. Për Bejtullahun kjo ishte

hera e parë që ndau drejtësinë në garat e UEFA-s dhe këto ndeshje i kanë shërbyer për të fituar përvojë ndërkombëtare dhe për ta dëshmuar nivelin e tij para zyrtarëve të UEFA-s. Dyshtja e gjyqtarëve kosovarë është vlerësuar pozitivisht për ndarjen e drejtësisë në këto ndeshje.



Milwaukee pëson humbje nga Bostoni, bie Denveri

MILWAUKEE, 31 MARS - Janë zhvilluar vetëm dy ndeshje së fundmi në NBA, por të dyja dhuruan spektakël. Skuadrat e kreut në dy konferencat u mundën në shtëpi, por ende mbeten në vend të parë. Në Lindje, Boston Celtics, që

mban vendin e dytë, fitoi thellë 140-99 ndaj kryesuesve të Milwaukee Bucksit. Skuadra e Celticsit dominoi dhe fitoi pa problem. Për miqtë u dalluan Tatum me 40 pikë dhe Browni me 30. Për vendasit, Antetokounmpo realizoi 24

pikë, por që mbetën për statistikë. Në Perëndim, skuadra e New Orleansit befasoi Denver Nuggetsit, duke fituar 107-88 jashtë fushës. Ingram me 31 pikë ishte më i miri në fushë për miqtë, mbështetur nga McCollum me

23 pikë. Për Denverin u dallua Murray me 21 pikë. Për kryesuesit u ndje shumë mungesa e Jokiçit. Pavarësisht prej humbjeve, si Milwaukee në Lindje, ashtu edhe Denveri në Perëndim mbrojnë vendin e parë.



Tre derbi në ligat evropiane: Napoli - Milan, City - Liverpool dhe Bayern - Dortmund

NAPOLI, 31 MARS - Në Serinë A ndeshja e fundjavës është ajo në mes të Napolit dhe Milanit të cilët do të "përplasen" së bashku të dielën mbrëma në orën 20:45 në "Maradona Stadio". Napoli kryesues do të tentojë sigurisht vetëm fitoren për të mos prishur as planet matematikore të fitimit të "Scudetto"-s. Milani do të jetë gjithashtu luftues për të siguruar një vend në top-treshe. Interi do të zbresë në fushë ditën e shtunë në "San Siro" kundër Fiorentinës, me "zikaltrit" që duan të lënë pas humbjet në kampionat dhe t'i vazhdojnë rezultatet pozitive për t'u përgatitur në sfidat e vështira si ajo ndaj Juventusit në Kupën e Italisë dhe atë mes Benfiksës në Ligën e Kampionëve. Në Premier Ligë e gjithë vëmendja është te përplasja e titanëve, ajo mes Manchester Cityt dhe Liverpoolit. Edhe pse City është superior mbi Liverpoolin, gjithmonë kjo ndeshje dhuron spektakël dhe gola nga të dyja skuadrat. Skuadra e Guardiola's do të tentojë për herë të fundit të ushtrorë presion mbi Arsenalin, por "Topçinjtë" duken të sigurt në hapat që hedhin. Gjithashtu, në këtë ditë Chelsea do



ta sfidojë në "Stamford Bridge" ekipin e Aston Villa, ndërsa të dielën Newcastle dhe Manchester Unitedi do ta mbyllin javën. Gjermania është bërë gati për të parë një përballje kokë me kokë ditën e shtunë në orën 18:30. Bayern Munich do t'i presë në shtëpi rivalët historikë të Borussia Dortmundit. Të dyja klubet janë në përballje me njëra-tjetrën në luftën për ta fituar kampionatin gjerman. Aktualisht Dortmundi ndodhet në vendin e parë me 53 pikë, ndërsa

Bayerni në vendin e dytë me një pikë më pak. Kjo ndeshje do të jetë e jashtëzakonshme, ku gjithashtu mund të jetë vendimtare për fitimin e trofeut. Në La Liga të Spanjës, ditën e shtunë, Barcelona do të niset drejt Elches për t'u ndeshur. Real Madridi dhe Atletico Madridi do të zbresin në fushë ditën e diel, me "Los Blancos" të cilët do ta presin në Bernabeu ekipin e Valladolidit, ndërsa "Colchoneros" do të presë Real Betisin.

Tuchel: Kam ardhur në kohë të pazakontë, por duam të fitojmë trofe

MUNCHEN, 31 MARS - Bayerni München do të luajë të shtunën një super duel ndaj Borussia Dortmundit. Thomas Tuchel ka nisur aventurën në krye të bavarezëve, teksa kjo do të jetë ndeshja debutuese për të. Pas 25 ndeshjeve të zhvilluara, "verdhezinjtë" udhëheqin kampionatin me një pikë më shumë se "bavarezët" dhe padyshim kjo përballje do të vendosë shumë për titullin kampion. Pas prezantimit zyrtar, trajneri i ri Thomas Tuchel doli edhe në konferencën e zakonshme për shtyp përpara ndeshjes. 49-vjeçari qëndroi për dy sezone në krye të Dortmundit, por pa mundur ta konkurronte Bayernin e Munichun në luftën për titullin kampion. "Kam besim të plotë tek



ekipi. Lojtarët janë mësuar të luajnë sfida të mëdha. E nis aventurën time te Bayerni në muajin prill, me një pikë prapa liderëve në Bundesligë. Jemi në çerekfinalët e kupës dhe luftojmë edhe për trofeun e Ligës së Kampionëve. Pra

jemi në garë për çdo titull. Ky është fokusi ynë. Është e vërtetë se është një kohë e pazakontë për të ardhur në një klub si Bayerni, por ne do ta bëjmë maksimumin për ta mbyllur sa më mirë sezonin", ka thënë Tuchel.

SHKURT

Trajneri i Galatasarayt kërkon blerjen e Rashicës

Milot Rashica është i huazuar në Stamboll te gjiganti turk Galatasaray. Sulmuesi "dardan" është bashkuar me skuadrën e madhe turke si huazim njëvjeçar nga Norwich City. Por pas paraqitjeve shumë të mira, të gjithë në klubin turk janë të bindur për ta blerë përfundimisht reprezentuesin kosovar. Madje mediet e ndryshme në Turqi kanë raportuar se trajneri Okan Buruk u ka kërkuar personalisht drejtuesve të klubit që sa më parë ta blejnë kartonin e Rashicës. Te skuadra turke janë bindur nga cilësitë e Rashicës dhe janë të gatshëm të shpenzojnë pesë milionë euro për blerjen përfundimtare të kartonit të tij. 26-vjeçari ka zhvilluar 20 ndeshje mes kampionatit dhe Kupës së Turqisë me gjigantin turk duke shënuar katër gola e duke asistuar në katër të tjerë. Rashica dhe Galatasaray po kërkojnë titullin e kampionit në Turqi, pasi kanë gjashtë pikë para Fenerbahçes.

Barça me çdo kusht dëshiron rikthimin e Messit

Leo Messi është i pavendosur në lidhje me të ardhmen. Triumfi në Botëror ka bërë që "pleshti" të reflektojë jo pak në lidhje me karrierën në rang klubesh. Barcelona po bën gjithçka për ta rikthyer Messin në "Camp Nou", por kjo mund të realizohet vetëm nëse argentinasi vjen falas. Sipas "Mundo Deportivo", drejtuesit e klubit bluagrana po lëvizin në shumë fronte për të realizuar këtë ëndërr të tifozëve. Në të njëjtën kohë, as PSG-ja nuk ka ndër mend të dorëzohet lehtë, sepse shekëti po bëjnë gjithçka për ta bindur Messin që ta rinovojë kontratën. Aktualja i përfundon në fund të këtij sezoni.

Arteta dhe Saka zgjedhen më të mirët e muajit mars në Premierligë

Dyshja e Arsenalit, trajneri Mikel Arteta dhe sulmuesi anësor Bukayo Saka, janë zgjedhur më të mirët e Ligës Premierie për muajin mars. Muaji mars ka qenë shumë i frytshëm për Arsenalin, pasi ka fituar të katër ndeshjet e luajtura këtë muaj, për ta mbajtur distancën nga Manchester City. Katër fitore në katër ndeshje dhe tetë pikë diferencë me Cityn kanë bërë që Arteta të vlerësohet trajneri më i mirë për muajin mars në Ligën Premierie. Përveç Artetas, me çmimin e më të mirë është vlerësuar edhe sulmuesi anësor, Saka. Saka ishte i papërmbajtshëm në muajin mars duke qenë vendimtar i Arsenalit në secilën fitore, pasi ka shënuar tri gola dhe ka dhuruar dy asistime në katër ndeshje.

Mbappe pranon kalimin në Real

Gazeta spanjolle "AS" në Spanjë bën me dije se kapiteni i Francës dhe sulmuesi i PSG-së, Kylian Mbappe, ua ka bërë të qartë drejtuesve parisienë se do të largohet nga skuadra në verën e vitit 2024, duke dashur ta realizojë ëndërrën e tij për t'u transferuar në Real Madrid. Mbappe është këmbëngulës për të ndërmarrë hapa dhe tashmë u ka thënë drejtuesve në Madrid se ai do të jetë një galaktikë më së voni deri në sezonin 2024-25. Kontrata e rinovuar pranverën e kaluar e lidhi atë me PSG-në deri në vitin 2025 nëse skuadra e PSG-së fiton Ligën e Kampionëve. Ndryshe, siç ndodhi me eliminimin në fazën e 16, lidhja e sulmuesit me ekipin aktual përfundon në vitin 2024. Kontrata do të zgjatet vetëm për një vit nëse Mbappe dëshiron, diçka që futbollisti ka vendosur të mos e bëjë. Sipas burimeve pranë lojtarit, Mbappe siguron se asgjë dhe askush nuk do të jetë në gjendje ta bëjë atë të ndryshojë mendje apo ta pengojë largimin e tij në Madrid.

Matthaus: Bayerni e largoi me të drejtë Naglesmanin

Lothar Matthaus ka ndryshuar sërish pllakën e qëndrimit rreth fituesit të "Klasikes" së Gjermanisë, madje është i bindur se Bayerni nuk do t'i përsërisë gabimet e së shkuarës. "Bavarezët

do të fitojnë si shkak i nervozizmit dhe pikërisht ky faktor do të jetë përcaktues në rezultatin final. Fryma e re me ardhjen e Tuchelit ka për të luajtur pjesën e vet. Fusha nuk u shpëton

avantazheve të vendësit, aq më tepër në një moment kaq delikat për fatet e sezonit. Jam i sigurt se problemet në qëndrueshmëri nuk kanë për t'u përsëritur në të ardhmen në München. Largimi i

Nagelsmanit mori trajtën e së detyrueshme, marrë në konsideratë luhatjet e vazhdueshme në lojë, ka thënë "rekordmeni" gjerman në rubrikën e tij sportive "Sky Sport".

Fillimisht 62-vjeçari doli hapur se Borussia Dortmundi do ta siguronte titullin në "Allianz Arena", por mesa duket zhvillimet e fundit kanë pasur ndikim të fortë në qëndrim.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Agro-Trade Group" Sh.p.k Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve dhe restoranti në Llapllasellë komuna e Graçanicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.05.2023 në ora 10:00 në shkollën fillore "Ditët e Minatorit" Fshati Kishnice - komuna e Graçanicës do të organizohet debat publik nga Kompania "Agro-Trade Group" Sh.p.k Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM


<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b25251MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Agro-Trade Group" Sh.p.k Graçanicë për stacionin e karburanteve dhe restoranti në Llapllasellë komuna e Graçanicës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shpetim Bahtijari shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Hilmi Bahtijari " Blaq/ Brodosan Dragash.

- Mirvet Rama shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Izvor " Lubinje e Epërme.

- Meriton Haxhaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Bardh Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Ardian Qarri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma

të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients


[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues